



RAPORT

ANALIZA E TREGUT RAJONAL TË PUNËS DHE E ZHVILLIMIT EKONOMIK NË ELBASAN

Shtator 2021

Tabela e Përmbajtjes

1	Përmbledhje ekzekutive	4
2	Historiku.....	6
3	Analiza e Tregut të Punës	14
4	Analizë e Detajuar Sektoriale.....	30
5	Tregu i Punës dhe Perspektivat e Zhvillimit	38
6	Përfundime dhe Rekomandime	42

Raport

Shtator 2021

Mohim përgjegjësie: *Ky material është përgatitur nga Kompania IDRA, me mbështetjen e RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC. Pikëpamjet dhe konkluzionet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.*

Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Lista e Figurave

Figura 1: Rritja e PBB-së 2005 – TM4 2020 (në %)	6
Figura 2: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2010 – 2020 (% e fuqisë punëtore për popullsinë në moshë pune dhe % e fuqisë punëtore të moshës 15-24 vjeç krahasuar me këtë popullsi në moshë pune)	7
Figura 3: Shkalla e papunësisë 2010 – TM4 2020 (% e fuqisë totale të punës dhe % e fuqisë punëtore të të rinjve të moshës 15-24 vjeç)	7
Figura 4: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas madhësisë 2013-2020	8
Figura 5: Ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik 2020	9
Figura 6: Popullsia e Qarkut Elbasan 2001 - 2021	10
Figura 7: Përqindja e PBB-së rajonale në total – 2019	10
Figura 8: PBB për frymë, çmimet aktuale në mijë lekë - 2019	10
Figura 9: Struktura e PBB-së në Elbasan, 2019	11
Figura 10: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2016 – 2020 në Elbasan (% e fuqisë punëtore ndaj popullsisë në moshë pune) – e zbërthyer sipas gjinisë	14
Figura 11: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2016 – 2020 në Elbasan (% e fuqisë punëtore ndaj popullsisë në moshë pune) – e zbërthyer sipas nivelit arsimor	14
Figura 12: Shkalla e papunësisë 2016 – 2020 në Elbasan (% e totalit të fuqisë punëtore) – e zbërthyer sipas gjinisë	15
Figura 13: Shkalla e papunësisë 2016 – 2020 në Elbasan (% e totalit të fuqisë punëtore) – e zbërthyer sipas nivelit arsimor	15
Figura 14: Punëkërkuës të papunë në zyrën rajonale të punësimit në Elbasan	16
Figura 15: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar kundrejt totalit të të papunëve të parashikuar	16
Figura 16: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar kundrejt papunësisë totale të parashikuar	17
Figura 17: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar sipas moshës	17
Figura 18: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar sipas gjinisë	18
Figura 19: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar sipas arsimit	18
Figura 20: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar sipas kohëzgjatjes së papunësisë	19
Figura 21: Përqindja e ndërmarrjeve të regjistruara në AKPA kundrejt totalit të ndërmarrjeve aktive në qark	20
Figura 22: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar të kundrejt vendeve të lira të punës të regjistruara	21
Figura 23: Vendet e lira të punës sipas aktivitetit ekonomik	21
Figura 24: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e Mallrave	22
Figura 25: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e mallrave: Prodhimi	22
Figura 26: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e Shërbimeve	23
Figura 27: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e Shërbimeve, të detajuara për vitin 2020	24
Figura 28: Vendet e lira të punës sipas profesionit	24

Figura 29: Vendet e lira të punës kundrejt të papunëve të regjistruar sipas profesionit në vitin 2020	25
Figura 30: Vendet e lira të punës kundrejt të papunëve të regjistruar për nënkategorinë e “artizanëve që përpunojnë ushqime, dru, tekstile, etj”	25
Figura 31: Pjesëmarrësit në programet e e nxitjes së punësimit	26
Figura 32: Numri total i të diplomuarve të AFP-së.....	26
Figura 33: Të diplomuarit e AFP-së sipas llojit të programit (2019)	27
Figura 34: Norma e rritjes së PBB-së rajonale (%) 2014 - 2019	28
Figura 35: Struktura e PBB-së në Elbasan 2014-2019 (në %)	29
Figura 36: Numri i ndërmarrjeve aktive në Elbasan (2015 – 2020).....	29
Figura 37: Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë (2015 – 2020)	30
Figura 38: Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik (2015 – 2020)	31
Figura 39: Skema e suficitit të krahut të punës me dy sektorë	36
Figura 40: Efektet e perspektivës sipërmarrëse	36

Lista e Tabelave

Tabela 1: Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas aktivitetit ekonomik (2015 – 2020)	30
Tabela 2: 20 sipërmarrjet kryesore aktive dhe të mëdha sipas llojit të aktivitetit - kodi 2 shifror NACE / renditur sipas madhësisë në vitin 2020 (2015 – 2020)	32
Tabela 3: 20 ndërmarrjet aktive me rritjen më të lartë sipas llojit të aktivitetit - kodi 2 shifror NACE / renditur sipas rritjes 5 vjeçare (2015 - 2020)	33

1 Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport shtjellohet vlerësimi i situatës aktuale dhe nevojave të tregut rajonal të punës dhe zhvillimit ekonomik në Elbasan. Ky vlerësim vjen pas një recesioni të madh në shkallë kombëtare të shkaktuar nga pandemia COVID-19, e cila ka krijuar një kontekst të ri në aspektin e zhvillimit kombëtar. Kjo kohë iu ka shërbyer bizneseve për të reflektuar dhe për tu riaktivizuar si dhe qeverisë për të zgjeruar mbulimin dhe për të garantuar një mjedis sa më rezilient. Kjo do të kërkojë aktivizimin e politikave dhe veprimeve në shumë fronte, dhe hartimin e strategjive për të nxitur punësimin dhe rritjen ekonomike në nivel lokal, si ndër elementet më të rëndësishme që nevojiten për të reaguar dhe për t'iu përgjigjur situatës me sukses.

Ekonomia vendore e Elbasanit karakterizohet nga një rritje e brishtë dhe zhvillim i ngurtë sektorial. Në vitet e shkuara rritja ekonomike në nivel vendor nuk paraqet ndonjë trend të qartë në aspektin e rritjes, duke kombinuar një rënie në vitin 2014 dhe 2015 me një rritje të pakonsiderueshme në vitet në vijim. Përsa përfaqësohet nga bujqësia (40.2% në vitin 2020) dhe ekonomia dominohet kryesisht nga ndërmarrjet bujqësore të vogla, të cilat me shumë gjasa janë biznese familjare. Gjatë viteve të shkuara, kjo strukturë nuk është përballur me ndonjë ndryshim të rëndësishëm, gjë që flet për ngurtësinë e saj dhe mungesën e inovacionit. I vetmi ndryshim i dukshëm është rritja e vogël e sektorit të industrisë nga 12.5% në 15.0% të PBB-së në nivel vendor.

Duke analizuar ndarjen sipas aktivitetit ekonomik, **gjatë viteve të fundit ndërmarrjet me rritje të lartë ishin më mbizotërueset në aktivitetet e prodhimit të mallrave.** Gjatë 5 viteve të fundit është vënë re një tendencë e vazhdueshme në rritje, ndërmarrjet aktive të prodhuesve të mallrave kanë dyfishuar peshën e tyre në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, nga 28% në vitin 2015 në 52% në vitin 2020. Kjo vjen kryesisht për shkak të regjistrimit masiv si biznese të vogla të aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale në vitin 2016 dhe nuk demonstroi ndonjë model të qartë të zhvillimit të ndonjë aktiviteti tjetër. Me qëllim eksplorim të mëtejshëm të dinamikës së ndërmarrjeve në rajon, INSTAT-i ka kryer një analizë në lidhje me 20 kategoritë kryesore sipas numrit të ndërmarrjeve, bazuar në klasifikimin 2 shifror NACE. Është e dukshme se gjatë viteve të fundit vetëm disa kategori kanë shënuar rritje, ndërsa në shumicën e kategorive vihet re një rënie e numrit të ndërmarrjeve aktive. Metodologjia e studimit aktual **merr në konsideratë teorinë moderne të specializimit të sektorit, sipas të cilës ekonomitë vendore mund të përballen me diversifikim të tepërt në momentin kur këto sektorë zbulojnë produktet më të favorshme për të cilat duhet të specializohen.** Megjithatë, duke analizuar rritjen e aktiviteteve specifike, ajo nuk zbulon ndonjë model specifik të sektorëve në rritje, në vend të bujqësisë, ndërtimit dhe tregtisë tradicionale. Rritja e sektorit të industrisë në fakt lidhet me rritjen sistematike të një ndërmarrjeje.

Duke patur parasysh kontekstin, zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi i kërkesës për krah pune duhet të udhëhiqet nga **teoria e ndryshimeve strukturore.**¹ Teoria përshkruan mekanizmin me anë të të cilit ekonomitë e pazhvilluara i transformojnë strukturat e tyre ekonomike të brendshme duke e zhvendosur theksin nga bujqësia tradicionale si mjet jetese tek ekonomia e prodhimit dhe shërbimeve më moderne, më të urbanizuara dhe më të larmishme në aspektin industrial. Tema e paraqitur është thelbësore për zhvillimin e tregut të punës në Elbasan. Analiza tregon se, nga të gjitha problematikat e tregut të punës, ajo më e rëndësishmja ka të bëjë me mungesën e kërkesës, ose mungesën e kërkesës së “sektorit modern”. Ndryshimi strukturor mund të ndodhë përmes

¹ Një përmbledhje e detajuar është paraqitur në seksionin 5.

rritjes së industrive të vogla me intensitet të lartë pune. Zgjerimi i këtyre industrive mund të arrihet përmes investimeve dhe stimujve të qeverisë dhe përmirësimit të qasjes tek kreditë, veçanërisht për aktivitetet sipërmarrëse. Në një kontekst të tillë, sfida themelore e punësimit në nivel vendor është **krijimi i vendeve të punës më cilësore** dhe vënia e tyre në dispozicion të të gjithëve. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë, **politikat që mbështesin iniciativat sipërmarrëse** si mënyra për të mbështetur krijimin e vendeve të punës janë politikat më praktike të punësimit.

Treguesit e nivelit makro për tregun e punës në Elbasan paraqesin një perspektivë të përzier të pjesëmarrjes dhe papunësisë në rajon. Megjithëse gjatë 5 viteve të fundit është vënë re një rënie e lehtë (-3,9 pp), shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2020 ishte 71% dhe rreth 9,4 pp mbi mesataren kombëtare prej 60,6%. Krahasuar me rënien e shkallës së pjesëmarrjes, shkalla e papunësisë pësoi një rënie edhe më të madhe, nga 13.9% në vitin 2016 në 7.1% në vitin 2020. Përveç trendeve natyrore demografike, **migrimi i fuqisë punëtore aktive është identifikuar si një problem i madh dhe i qartë**, gjë e cila krijon probleme të shumta për çdo politikë të tregut të punës. Dallimet midis mundësive të punësimit në Tiranë dhe Elbasan të shkaktuara nga prirja e përqendrimit, veçanërisht kryeqytet-qytet, dhe strategjive të zhvillimit duhet të reduktohen, pasi fluksi i kapitalit njerëzor ka çuar në mungesë të fuqisë punëtore, por edhe në mungesë sipërmarrjeje.

Të dhënat në lidhje me punëkërkuarit e regjistruar sugjerojnë se fuqia punëtore aktuale e papunë është e pakualifikuar, e moshuar dhe e papunë për një periudhë afatgjatë. Kjo situatë është e pritshme kur merret parasysh tipologjia e kualifikimit të ulët të punëkërkuarëve, ku mungesa e aftësive bazë, kualifikimeve dhe përvojës në punë shihen shpesh si barrierat kryesore me të cilat përballen personat që vuajnë nga papunësia afatgjatë. Midis këtyre grupeve mund të ketë mungesë të aftësive teknike, ose vjetrim të këtyre aftësive dhe njohurive nëse ato nuk përditësohen rregullisht krahas me zhvillimin e sektorit përkatës. Ndoshta kjo ka ardhur si rezultat i faktit që shumë prej punëtorëve të moshuar kanë hyrë në tregun e punës me kapital të ulët njerëzor dhe janë përpjekur shumë pak për të lehtësuar situatën. Fillimisht, politika e punësimit duhet të fokusohet **në ngritjen e aftësive** të kësaj tipologjie të fuqisë punëtore për të përmirësuar situatën afatshkurtër. Aftësitë teknike (si zejtaria) janë lehtësisht të transferueshme dhe duhet të jenë në fokusin e strategjisë afatshkurtër.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor përmes AFP-së dhe niveleve më të larta është një komponent thelbësor i sistemit arsimor. Për aftësitë teknike dhe praktike duhet të zhvillohen programet dhe kurrikulat e trajnimit bazuar në standardet e profesioneve që marrin parasysh kërkesat specifike të një nevojë të tregut të punës. Prandaj kompanitë duhet të përfshihen në mënyrë aktive si në përcaktimin e standardeve ashtu edhe në hartimin e kurrikulave. **Përdorimi i teknologjisë, duke përfshirë digjitalizimin dhe automatizimin, janë duke i riformësuar rrënjësisht nevojat e punëdhënësve për aftësi.** Vendet e punës që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të nxitura nga metodat e kontraktimit të jashtëm, janë rritur në mbarë vendin duke ofruar kështu një shteg të qartë për të ardhmen e punës. Në të njëjtën qasje, universitetet duhet të sigurohen që kurrikulat e tyre të mbeten relevante duke u orientuar nga intutita e industrisë dhe palëve përkatëse të interesit për të peshuar nevojat aktuale dhe të ardhshme për aftësi.

2 Historiku


2.1 Konteksti i zhvillimit kombëtar

Vitet e fundit Shqipëria është karakterizuar nga zhvillime pozitive ekonomike, duke prodhuar kështu një mjedis makroekonomik të qëndrueshëm. Pas krizës së mëparshme financiare globale, Shqipëria u prezantua si një ekonomi me rritje të shpejtë, duke shfaqur progres të konsiderueshëm në sektorë të ndryshëm. Problemet ekonomike botërore u bënë shkak për krijimin e një periudhe të karakterizuar nga rritja e ngadaltë, ndërkohë që rruga drejt rimëkëmbjes rezultoi e vështirë dhe disi e gjatë. Megjithatë, gjatë viteve 2017 dhe 2018, rruga e rimëkëmbjes dukej më e evidente dhe trendi i vazhdueshëm pozitiv ishte rezultati i pritshëm i programeve zhvillimore.

Megjithatë, Shqipëria aktualisht po përballet me sfidat e shkaktuara nga dy goditje të mëdha: tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe pandemia COVID-19. Tërmeti i nëntorit (2019) ishte tërmeti më i fortë që ka goditur Shqipërinë në katër dekada. Nevoja për të adresuar ndikimin social-ekonomik të këtyre ngjarjeve ishte e menjëhershme për grupet vulnerabël dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat e prekura. Ndërsa rindërtimi sapo kishte filluar, vendi u prek rëndë edhe nga pandemia globale e sëmundjes së koronavirusit (COVID-19).

E ndikuar kryesisht nga tërmeti, tendenca e rritjes e parashikuar në vitin 2019 u tkurr në një rritje prej 2.21%. Pandemia COVID-19 dhe izolimi i hershëm gjatë muajve mars-maj 2020 çuan me të vërtetë në një recesion të konsiderueshëm gjatë tremujorit të parë dhe aq më shumë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Recesioni filloi gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 dhe arriti kulmin me 10.23% rënie në tremujorin e dytë, duke arritur të rikuperohej vetëm në tremujorin e fundit me një rritje prej 2.99%.


Figura 1: Rritja e PBB-së 2005 – TM4 2020 (në %)



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe nivelet e larta të papunësisë vazhdojnë të karakterizojnë tregun kombëtar të punës. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në dekadën e fundit është luhatur midis 50-60%, duke kapur pikën e saj më të ulët në vitin 2013 në 52.4% dhe duke arritur kulmin në vitin 2019 në 60.4%. Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve qëndron në një nivel shumë më të ulët se norma totale e pjesëmarrjes, ku pika e saj më e ulët u regjistrua në vitin 2013 në masën 27.6% dhe kulmi në vitin 2019 në masën 36.7% (vjetore).


Figura 2: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2010 – 2020 (% e fuqisë punëtore për popullsinë në moshë pune dhe % e fuqisë punëtore për të rinjtë 15-24 vjeç krahasuar me këtë popullsi në moshë pune)



Burimi: INSTAT Anketa e Forcave të Punës, tregues vjetorë dhe tremujorë, 2021; Analiza e kryer nga IDRA.

Efektet ekonomike të pandemisë janë të dukshme gjatë vitit 2020 kur bëhet fjalë për punësimin. Sipas INSTAT-it, norma zyrtare e papunësisë në Shqipëri për popullsinë 15 vjeç e lart ishte 11,8% për tremujorin e fundit të vitit 2020. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2019, norma zyrtare e papunësisë është rritur me 0,6 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020, norma zyrtare e papunësisë u rrit me 0,2 pikë përqindje. Më tej, niveli i papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç) vazhdon të jetë shumë më i lartë. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 kjo normë kapi shifrën 26.4% ndërsa gjatë tremujorit të fundit të vitit 2020, norma e papunësisë tek të rinjtë ishte 28.3%, shifër kjo e rritur me 2.7 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e tretë.

Figura 3: Shkalla e papunësisë 2010 – TM4 2020 (% e fuqisë totale të punës dhe % e fuqisë punëtore të të rinjve të moshës 15-24 vjeç)



Burimi: INSTAT Anketa e Forcave të Punës, tregues vjetorë dhe tremujorë, 2021; Analiza e kryer nga IDRA.

Analiza e Nevojave për Aftësi e kryer në vitin 2017 nga UNDP-ja, ofron informacion të vlefshëm në lidhje me mungesat në tregun e punës, dhe synon të paraqesë një tablo të nevojave për aftësi dhe të aftësive të munguara në vend. Sipas raportit, kualifikimi i papërshtatshëm dhe kultura e punës janë shqetësimet më të përsëritura për punëdhënësit. Kualifikimi i papërshtatshëm (që buron nga një sistem arsimor që nuk arrin të plotësojë nevojat e ekonomisë) është një problem real për minierat dhe industrinë nxjerrëse, si dhe për furnizimin me energji elektrike, gaz dhe avull, ndërkohë që kultura e punës është një shqetësim i veçantë për sektorin e informacionit dhe komunikimit dhe sektorin financiar dhe të sigurimeve.


Meqenëse mungesa e aftësive në rradhët e stafit ekzistues është dyfishuar që nga viti 2014, furnizimi me ujë, kanalizimet dhe mbetjet, si dhe minierat dhe industria nxjerrëse janë sektorët që vuajnë më shumë nga mungesa e aftësive përkatëse tek punonjësit e tyre aktualë. Më tej, punëdhënësit në bare, restorante dhe hotele në vend duket se janë kryesisht të pakënaqur me nivelin e aftësive të personelit të tyre.

Duke marrë parasysh krijimin e vendeve të punës, raporti e cilëson prodhimin si sektorin kryesor, një pjesë e madhe e së cilës zhvillohet në industrinë e modës dhe veshjeve, e ndjekur nga informacioni dhe komunikimi dhe shërbimet administrative dhe mbështetëse. Qepja dhe montimi në industrinë fashione është profesioni kryesor që krijon premisa për hapjen e vendeve të punës, e ndjekur nga operatorët e qendrave të thirrjeve telefonike, kamerierët dhe punëtorët e ndërtimit.

Numri i ndërmarrjeve aktive në vitin 2020 në Shqipëri ishte gjithsej 166,384. Gjatë viteve të fundit, numri i përgjithshëm ka pësuar rritje, ku mund të përmendim rritjen e theksuar në vitin 2015 dhe një rritje tjetër të konsiderueshme në vitin 2016, si rezultat i regjistrimit të fermerëve individualë me NIPT (Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm) si ndërmarrje. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë kontribuese të rëndësishme në ekonominë shqiptare. Sipas raportit narrativ pas publikimit të bazës së të dhënave statistikore të konsoliduara të vitit 2019:²

- 99.8 % e ndërmarrjeve aktive janë NVM.
- 81.6 % e numrit total të të punësuarve janë të punësuar nga NVM-të.
- 78.9 % e xhiros është realizuar nga NVM-të.
- 68.2 % e totalit të investimeve janë realizuar nga NVM-të.

Figura 4: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas madhësisë 2013-2020



² INSTAT, Statistikat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, 2019.

Burimi: INSTAT - Baza e të dhënave statistikore të regjistrit të bizneseve, 2020

Duke marrë parasysh aktivitetin ekonomik, 60.9% e ndërmarrjeve janë prodhues të shërbimeve, ndërsa 39.1% janë prodhues të mallrave (Figura 5). Sektori me numrin më të madh të ndërmarrjeve është bujqësia, pyjet dhe peshkimi (30.3%), i ndjekur nga tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave (26.2%) dhe aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (10.6%). Përqindjen më të ulët të numrit të ndërmarrjeve aktive e kanë sektori i furnizimit me ujë, kanalizimeve, menaxhimit dhe sanimit të mbetjeve (0.2%), furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (0.3%) dhe sektori i minierave dhe industrisë nxjerrëse (0.5%).

Figura 5: Ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik 2020


Aktiviteti ekonomik	Nr. i ndërmarrjeve	Përqindja ndaj totalit
Prodhuesit e mallrave	65,042	39.1%
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	50,411	30.3%
Minierat dhe industria nxjerrëse	803	0.5%
Prodhimi	7,984	4.8%
Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	493	0.3%
Furnizimi me ujë, kanalizimet, menaxhimi dhe sanimi i mbetjeve	291	0.2%
Ndërtimi	5,060	3.0%
Prodhuesit e shërbimeve	101,344	60.9%
Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	43,668	26.2%
Transporti dhe magazinimi	5,708	3.4%
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	17,713	10.6%
Informacioni dhe komunikimi	3,349	2.0%
Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve	1,376	0.8%
Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	933	0.6%
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	7,363	4.4%
Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	3,604	2.2%
Administrata publike dhe mbrojtja; aktivitetet e detyrueshme sociale	756	0.5%
Arsimi	1,287	0.8%
Aktivitetet për shëndetin e njeriut dhe punën sociale	3,961	2.4%
Arte, argëtim dhe rekreacion	1,332	0.8%
Aktivitete të tjera shërbimi	10,294	6.2%
Gjithsej	166,386	100.0%

Burimi: INSTAT - Baza e të dhënave statistikore të regjistrit të bizneseve, 2020.

2.2 Konteksti i zhvillimit vendor

I ndodhur në një pozicion të favorshëm gjeografik, i pasur me burime natyrore, së bashku me trashëgiminë e tij historike dhe social-kulturore, Elbasani është një nga rajonet më të rëndësishme në Shqipëri. Elbasani ka një popullsi prej 266,245 banorësh,³ duke u renditur kështu si rajoni i katërt më i madh në vend me 9.4% të popullsisë shqiptare. Ashtu si çdo rajon në Shqipëri, popullsia ka ardhur në rënie gjatë 20 viteve të fundit, në këtë rast me një rënie prej rreth 26% (Figura 6), kryesisht për shkak të migrimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe dinamikave të tjera demografike.


Figura 6: Popullsia e Qarkut Elbasan 2001 - 2021



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.


Elbasani ka një aktivitet të konsiderueshëm ekonomik, i cili përfaqëson 7% të PBB-së së vendit, duke u renditur i katërti në krahasim me rajonet e tjera. Megjithatë, duke marrë parasysh PBB-në për frymë, rajoni renditet i dyti nga fundi, duke u konsideruar si një nga rajonet më pak të pasura.

Figura 7: Përqindja e PBB-së rajonale në total – 2019



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Figura 8: PBB për frymë, çmimet aktuale në mijë lekë - 2019




Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

³ INSTAT, Popullsia Shqiptare – 1 janar 2021, 2021.

Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në rajon, i cili kontribuon në rreth 40.2% të PBB-së rajonale, e ndjekur nga industria me 15.0% të PBB-së rajonale.

Figura 9: Struktura e PBB-së në Elbasan, 2019



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Plani i Përgjithshëm i Zhvillimit në Shqipëri 2015 – 2030 e sheh vendndodhjen qendrore të bashkisë së Elbasanit për sa i përket shtrirjes gjeografike të territorit, si një bazë solide bashkëpunimi me polin e zhvillimit rajonal Tiranë-Durrës, duke pasur parasysh lidhjen më të mirë me Tiranën nëpërmjet rrugës Elbasan-Tiranë. Nga ana tjetër, Elbasani do të shërbejë si pikë qendrore për lidhjen e Korçës me Beratën, duke lehtësuar aktivitetin ekonomik. Më tej, Plani i Përgjithshëm i Zhvillimit 2015 – 2030 parashikon edhe realizimin e disa ndërhyrjeve strategjike për zhvillimin e rajonit:

- Vlerësimi i mundësisë së krijimit të parqeve fotovoltaike, për të shfrytëzuar 2,500 orë diellore në vit.
- Riaktivizimi i linjës hekurudhore, pjesë e Korridorit VIII, për garantimin e lidhjes së qëndrueshme që mbështet zhvillimin e tregtisë dhe transportin e qëndrueshëm të mallrave nga Deti i Zi në portin e Durrësit.
- Projekti strategjik i ringjalljes së itinerarit antik të “Via Egnatia” në promovimin e turizmit që mbështet dhe vlerëson traditat dhe historinë e vendit tonë.
- Mbështetja për promovimin e turizmit elitare në zonat termale, turizmit malor në pika turistike si Gjinari.

Edhe në Plani Vendor Territorial 2016 shtjellohet konteksti për zhvillimin ekonomik të zonës. Fillimisht, njihet pozicioni strategjik i zonës, e cila është shumë afër Tiranës si kryeqytet, Durrësit si porti më i madh (dhe kryesor) në Shqipëri, afër kufirit me Maqedoninë e Veriut në Qafë Thanë (65 km) dhe si një qytet tranzit për një nga dy pikat kryesore kufitare të Greqisë në Kapshticë. Sa i takon

perspektivës së zhvillimit, Elbasani është një nyje, që bashkon Shqipërinë juglindore me qendrën dhe jugperëndimin, kufirin e Maqedonisë së Veriut me Portin e Durrësit dhe kufirin grek me kryeqytetin e Shqipërisë. Në këtë këndvështrim, pozicionimi është shumë i favorshëm për zhvillimin lokal.

Megjithatë, në Planin Vendor Territorial, megjithëse njihet e shkuara e saj industriale, përshkrimi ekonomik vendor flet për një ekonomi thellësisht bujqësore. Prandaj, në këtë plan sugjerohet që bujqësia duhet të jetë në fokusin e zhvillimit vendor, duke rekomanduar veçanërisht rritjen e produktivitetit dhe komercializimin e tokës dhe produktit. Konkretisht, plani rekomandon krijimin e një tregu të madh bujqësor rajonal, i cili mund të rrisë qasjen tek tregjet e produkteve bujqësore dhe të krijojë një përputhje më të mirë midis ofertës dhe kërkesës. Më tej, plani rekomandon mbështetjen e agroturizmit pasi shumë zona bujqësore në rajon kanë potencialin për të shërbyer si atraksione turistike.

Krahas Planit Vendor Territorial 2016, një dokument tjetër i rëndësishëm është “Strategjia për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Elbasan për vitin 2016”. Dokumenti fokusohet në vizionin vendor të zhvillimit territorial, mjedisor dhe social-ekonomik, së bashku me objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit – të ndjekura nga plani përkatës i veprimit si dhe nga një listë e projekteve prioritare dhe strategjike për zhvillimin vendor territorial. Dokumenti paraqet *pesë objektiva strategjike* për zhvillimin e bashkisë së Elbasanit:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, ruajtja e ekuilibrave ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe rritja e konkurrencës dhe diversitetit ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.
2. Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe reziliencës ekonomike nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor.
3. Përmirësimi i infrastrukturës për të mbështetur lëvizshmërinë efektive, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe reduktimin e trafikut.
4. Promovimi i sektorit të bujqësisë, si sektor kyç për zhvillimin e ekonomisë vendore dhe rritjen e punësimit, dhe veçanërisht për forcimin e zhvillimit rural.
5. Reduktimi i pabarazive sociale nëpërmjet përmirësimit të sistemeve arsimore dhe shëndetësore si dhe politikave sociale gjithëpërfshirëse për strehimin.

Megjithëse secili nga objektivat ka lidhje me zhvillimin ekonomik të rajonit, objektivi i parë dhe i katërt janë më të drejtpërdrejtë. Ndërsa objektivi i parë përcakton narrativën e zhvillimit dhe natyrën ndërsektoriale të tij, objektivi i katërt e njeh bujqësinë si sektorin kryesor që nxit rritjen ekonomike. Objektivat strategjike ndiqen edhe nga një sërë *programesh* që ofrojnë një kontekst më specifik në aspektin e zhvillimit:

- Mbështetja me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë në zonën e Metalurgjisë (O1P1).
- Mbështetja e sipërmarrjes dhe biznesit privat për të gjeneruar aktivitetin e tyre në ish-zonat industriale ekonomike të Elbasanit në bashkëpunim me Bashkinë si negociator kryesor për rigjenerimin e hapësirës publike nëpërmjet instrumentit të menaxhimit të tokës (O1P2).
- Mbështetja, marketimi, promovimi, përmirësimi i klimës dhe trajnimi i biznesit vendor për zhvillimin e ekonomisë vendore (O1P4).
- Hartimi dhe zbatimi i planit sektorial për turizmin në nivel bashkie (O2P7).
- Konceptimi dhe hartimi i instrumenteve për administrimin e tokës, të cilat do të orientojnë zhvillimet në sektorin e bujqësisë (O4P2).

- Promovimi i zhvillimit të strukturave për bujqësinë (magazina, stalla, pika grumbullimi, kooperativa, qendra informacioni, tregje rajonale, tregje javore, etj.) nëpërmjet përdorimit të aseteve publike dhe private në skemat e partneritetit publik-privat (PPP) (O4P3) – duke përfshirë:
 - Hartimin e projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi për produktet bujqësore.
 - Ndërtimin e tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zona të përshtatshme.
- Ngritja e disa departamenteve publike për arsimin e lartë në Bashkinë Elbasan, kryesisht të fokusuar tek profesionet e mjekësisë dhe inxhinierisë (O5P3).
- Në mbështetje të politikave kombëtare të ministrisë, stimuj për arsimin profesional, nëpërmjet investimeve në tre shkollat profesionale ekzistuese dhe një shkollë të re në Bashkinë Elbasan (O5P4).

Programet e identifikuar shërbejnë si një kornizë e shëndoshë ndërhyrëse. Konsultimet me Bashkinë e Elbasanit treguan se kjo kornizë është mjaft thelbësore për punën e bashkive. Megjithëse nuk ekziston një plan i detajuar zbatimi për secilin prej projekteve të paraqitura, këto programe dhe projekte shërbejnë si një spirancë për punën e tyre strategjike.


Sa i takon tre programeve të para (O1P1, O1P2 dhe O1P4), sipas bashkisë, progresi ka qenë real dhe i prekshëm. Është rritur interesi i kompanive të mëdha për të hapur biznesin e tyre në zonën e metalurgjisë për shkak të kushteve aktuale industriale (si hapësira e madhe, sistemi industrial i furnizimit me energji dhe ujë, etj.) si dhe për zonën ekonomike të Elbasanit, e cila ofron avantazhe për këto biznese. Për më tepër, bashkia ka filluar të luajë një rol më aktiv për mbështetjen e bizneseve vendore dhe tërheqjen e bizneseve të reja. Përveç ofrimit të orientimit strategjik, bashkia po përpiqet të krijojë edhe një rrjet me qëllim adresimin sa më të mirë të problematikave të tyre, duke përfshirë furnizimin me fuqi punëtore.

Nga ana tjetër, megjithë iniciativat e vogla, programet bujqësore nuk kanë qenë shumë të suksesshme për të ofruar një transformim thelbësor në sektorin e bujqësisë. Sipas bashkisë, bujqësia është ende në gjendjen e saj parësore: kryesisht prodhim dhe përpunim i rastit. Ndërsa struktura e ndërmarrjeve bujqësore është ende me bazë familjare dhe në shkallë të vogël.

3 Analiza e Tregut të Punës

Tregu i punës në qarkun e Elbasanit paraqet një perspektivë relativisht pozitive për punësimin në qark. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2020 ishte 71% (Figura 10), rreth 9.4pp mbi mesataren kombëtare prej 60.6% (shih Figurën 2). Megjithatë, duke pasur parasysh perspektivën 5-vjeçare, shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes ka rënë lehtësisht, konkretisht 3.9 pikë përqindje nga viti 2016. Të dhënat e zbërthyer flasin për një hendek të vazhdueshëm gjinor në shkallën e pjesëmarrjes. Në periudhën e paraqitur, shkalla e pjesëmarrjes për burrat është rreth 7.6 pikë përqindje më e lartë se për gratë, duke dëshmuar kështu për një fuqi punëtore shumë më pak aktive në rradhët e grave.


Figura 10: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2016 – 2020 në Elbasan (% e fuqisë punëtore kundrejt popullsisë në moshë pune) – e ndarë sipas gjinisë



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

E zbërthyer sipas nivelit arsimor, popullsia në moshë pune që ka të paktën një diplomë universitare është fuqia punëtore më aktive, duke paraqitur edhe luhatje të mëdha ndër vite. Si personat me shkollë 9-vjeçare ashtu edhe ata me shkollë të mesme, shfaqin përqindje më të ulëta të pjesëmarrjes dhe trend në rënie. Duke qenë se fuqia punëtore me shkollë të mesme ka një përqindje më të ulët pjesëmarrjeje sesa fuqia punëtore me arsim 9-vjeçar, arsyeja mund të shpjegohet me pjesëmarrjen e tyre në arsimin e lartë.


Figura 11: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2016 – 2020 në Elbasan (% e fuqisë punëtore kundrejt popullsisë në moshë pune) – e zbërthyer sipas nivelit arsimor



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Sa i takon normës së papunësisë, tregu i punës në qarkun e Elbasanit ka njohur më shumë zhvillime pozitive. Megjithatë shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ka pësuar rënie gjatë periudhës 5-vjeçare, norma e papunësisë ka rënë edhe më shumë, me 6.9 pp, nga 13.9% në vitin 2016 në 7.1% në vitin 2020. Edhe pse vihen re disa dallime gjinore, ato nuk janë aq të rëndësishme sa të krijojnë një model të vazhdueshëm në këtë aspekt.


Figura 12: Shkalla e papunësisë 2016 – 2020 në Elbasan (% e totalit të fuqisë punëtore) – e zbërthyer sipas gjinisë



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Gjatë periudhës 5-vjeçare, norma e papunësisë është më e ulët në mesin e fuqisë punëtore me shkollë 9 vjeçare, me përjashtim të vitit 2020 kur fuqia punëtore me shkollë të mesme ka arritur një normë pak më të ulët (0.3 pp). Nga ana tjetër, fuqia punëtore me arsim të lartë priret të ketë një shkallë më të lartë papunësie, e cila mund të vijë si rezultat i kërkesës më të vogël për fuqi punëtore të kualifikuar.

Figura 13: Shkalla e papunësisë 2016 – 2020 në Elbasan (% e totalit të fuqisë punëtore) – e zbërthyer sipas nivelit arsimor




Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Punëkërkuessit e papunë regjistrohen pranë Zyrës Rajonale të Punësimit në Elbasan, ku mund të përfitojnë shërbime punësimi si këshillimi për karrierën, ndërmjetësimi për punë, formimi profesional falas në qendrat publike të formimit profesional dhe pjesëmarrje në programet aktive për nxitjen e punësimit. Gjithashtu, punëkërkuessit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit mund të përfitojnë edhe pagesën e papunësisë në bazë të kriterëve përkatëse. Në vitin 2020, në

qarkun e Elbasanit ishin të regjistruar 10,672 punëkërkes të papunë, shumica e të cilëve banonin në Elbasan. Duke marrë parasysh afatin kohor 5-vjeçar, është vënë re një rënie e numrit të punëkërkesve të papunë të regjistruar nga viti 2016 deri në vitin 2019 prej 33,5%, ndërsa në vitin 2020 është regjistruar një rritje e ndjeshme e këtij numri në masën 17,1%.

Figura 14: Punëkërkes të papunë në zyrën rajonale të punësimit në Elbasan



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Parashikimi i nivelit të papunësisë në bazë të të dhënave të INSTAT-it për shkallën e papunësisë dhe për popullsinë zbulon një prirje të përbashkët me të dhënat e punëkërkesve të papunë të regjistruar, megjithëse rënia e papunësisë nga viti 2016 deri në vitin 2017 ka qenë më e mprehtë sesa shifra e paraqitur nga të dhënat e INSTAT-it (26,9% kundrejt 14,3%). Rritja si në parashikimet e papunësisë ashtu edhe të punëkërkesve të papunë flet për një rritje të papunësisë si rezultat i recesionit të shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Figura 15: Punëkërkesit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit kundrejt totalit të të papunëve të parashikuar




Burimi: AKPA (2021); INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA

Duke kombinuar projeksionet e INSTAT-it me të dhënat e AKPA-s, numri i punëkërkesve të papunë të regjistruar (bazuar në të dhënat e AKPA) krahasuar me papunësinë totale të parashikuar (bazuar në të dhënat e INSTAT) shërben si tregues për mbulimin e papunësisë për institucionin rajonal.

Kështu, në vitin 2016, 61% e të papunëve ishin të regjistruar në zyrën rajonale të punësimit në Elbasan. Nga viti 2016, është vënë re një tendencë e vazhdueshme në rritje, duke kapur vlerën 118.3% në vitin 2019 dhe 118.6% në vitin 2020. Trendi pozitiv flet për efektivitetin e punës së zyrës rajonale të punësimit për ofrimin e shërbimeve, pasi cikli i përshtypjeve dhe reagimeve pozitive është përcaktuesi kryesor për rritjen e regjistrimit të të papunëve. Nga ana tjetër, të dhënat e vitit 2019 dhe 2020 sugjerojnë se numri i punëkërkuessve të regjistruar në zyrën rajonale të punës është më i lartë sesa numri i të papunëve realë në rajon. Këtu duhet të kemi parasysh dy faktorë të rëndësishëm. Faktori i parë ka të bëjë me marzhin e gabimit të të dhënave të anketës së Forcave të Punës e kryer nga INSTAT-i, dhe paragjykimet e mundshme të kampionimit, që mund të kenë nënvlerësuar shkallën e papunësisë. Së dyti, duke supozuar se niveli i papunësisë qëndron, këto rezultate flasin për nivele të larta të punësimit informal (dhe ndoshta rastësor). Prandaj, punëkërkuessit qëndrojnë të regjistruar në zyrën rajonale të punësimit ndërkohë që janë të punësuar në mënyrë informale.


Figura 16: Punëkërkuessit e papunë të regjistruar krahasuar me normën totale të papunësisë së parashikuar



Burimi: AKPA (2021); INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Bazuar në të dhënat rajonale në lidhje me punëkërkuessit e papunë të regjistruar nga AKPA, analiza jonë vazhdon të eksplorojë më tej zberthimin kryesor të të dhënave. Të zberthyera sipas moshës, është e qartë se punëkërkuessit e papunë të regjistruar priren të jenë punëkërkuess të moshave të mëdha. Në vitin 2020, 37% e të papunëve të regjistruar ishin mbi 50 vjeç dhe duke marrë parasysh afatin kohor 5-vjeçar, shifra arriti kulmin në 42% në vitin 2019. Nga ana tjetër, në vitin 2020, vetëm 18% e të papunëve të regjistruar ishin të moshës 15-29 vjeç.


Figura 17: Punëkërkuessit e papunë të regjistruar sipas moshës



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Të zërthyerat sipas gjinisë, gjatë 5 viteve të fundit është vënë re një tendencë e lehtë sa i takon regjistrimit të grave si punëkërkuessë të papuna. Në vitin 2020, 53% e punëkërkuessve të papunë të regjistruar ishin gra, krahasuar me 47% burra.

Figura 18: Punëkërkuessit e papunë të regjistruar sipas gjinisë




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Analizimi i nivelit arsimor të punëkërkuessve të papunë të regjistruar është një tregues i mirë për nivelin e aftësive të të papunëve. Rezultatet tregojnë se gjatë 5 viteve të fundit shumica e punëkërkuessve të papunë kanë përfunduar shkollën 9-vjeçare, gjë që flet për kualifikimin e tyre të ulët. Konkretisht në vitin 2020, 64% e punëkërkuessve të papunë kanë mbaruar shkollën 9-vjeçare, ndërsa 20% kanë përfunduar shkollën e mesme dhe 10% shkollën profesionale. Nga ana tjetër, vetëm 6% e punëkërkuessve të papunë të regjistruar kanë përfunduar universitetin ose një nivel më

të lartë studimi. Duke marrë parasysh pjesën që ka përfunduar shkollën profesionale dhe një universitet ose nivel më të lartë studimi si fuqi punëtore e kualifikuar, rezultatet sugjerojnë se pjesa dërrmuese e punëkërkuessve të papunë janë me aftësi të ulëta.

Figura 19: Punëkërkuessit e papunë të regjistruar sipas nivelit arsimor




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA

Zhvillimi i aftësive mund të kontribuojë për transformimin strukturor dhe rritjen ekonomike duke rritur punësueshmërinë dhe produktivitetin e krahut të punës dhe duke ndihmuar rajonin të bëhet më konkurrues. Aftësitë teknike (që i referohen njohurive të fituara, ekspertizës dhe ndërveprimeve të nevojshme për të kryer një detyrë specifike, duke përfshirë edhe aftësinë për të përdorur materialet, mjetet ose teknologjitë e nevojshme) janë shumë më të rëndësishme për këtë situatë, pasi ato janë më të lehta për t'u përfutur nga njerëz me aftësi të ulëta. Prandaj, investimi për ngritjen e aftësive të kësaj fuqie punëtore mund të krijojë një cikël, ku aftësitë përkatëse dhe cilësore mundësojnë punësimin.

Për më tepër, rezultatet tregojnë se papunësia afatgjatë është mjaft e pranishme në rradhët e të papunëve të regjistruar. Figura 20 paraqet kohëzgjatjen që punëkërkuessit e papunë qëndruan të regjistruar në zyrën rajonale të punësimin. Në vitin 2020, 59% e punëkërkuessve të papunë kanë qenë të regjistruar për më shumë se 1 vit (29% prej të cilëve 1-3 vjet ndërsa 30% më shumë se 3 vjet). Kjo është një situatë e pritshme kur merret parasysh tipologjia e kualifikimit të ulët të punëkërkuessve, ku mungesa e aftësive bazë, kualifikimeve dhe përvojave të freskëta të punës shihen shpesh si barrierat kryesore me të cilat përballen personat e papunë për një periudhë afatgjatë. Përveç kësaj, në rajonet relativisht të dëshpëruara, vazhdimi i papunësisë afatgjatë është shpjeguar tradicionalisht duke iu referuar mungesës së kërkesës së lokalizuar ose si funksion i mospërputhjes së aftësive të perceptuara dhe problemeve të tjera nga ana e ofertës. Meqenëse mungesa e kërkesës mund të gjurmohet jo vetëm në nivel vendor, por edhe në nivel kombëtar, nivelet e ulëta të arsimimit në rradhët e punëkërkuessve janë një tregues i mirë për mospërputhjen e madhe të aftësive, pasi probabiliteti që personat me aftësi të ulëta të mos përshtaten me asnjë pozicion pune është jashtëzakonisht i lartë.

Figura 20: Punëkërkuësit e papunë të regjistruar sipas kohëzgjatjes së papunësisë




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Duke kombinuar tre tendencat kryesore në grupin e të dhënave për punëkërkuësit, tipologjia e tyre mund të kategorizohet si punëkërkuës të moshuar, me aftësi të ulëta dhe të papunë afatgjatë. Prandaj, kjo sjell implikimet e saj në situatën aktuale dhe në objektivat e synuara për t'u arritur në nivel politikash. Normalisht, punëtorëve të moshuar iu ka mbetur vetëm një periudhë e shkurtër për punësimin e tyre të mundshëm dhe punëdhënësit mund t'i konsiderojnë ata si më pak fleksibël dhe, për këtë arsye, edhe më pak tërheqës sesa fuqia punëtore më e re në moshë.

Për më tepër, për shkak të niveleve të ulëta arsimore, në mesin e këtyre grupeve vihet re edhe prezenca e aftësive të vjetëruara, jo të përditësuara. Në moshat më të mëdha kjo përfshin fillimisht reduktimin e forcës fizike, energjisë dhe rezistencës, gjë që është e rëndësishme veçanërisht në punët manuale dhe në punë të tjera fizike. Së dyti, midis këtyre grupeve mund të ketë mungesë të vërtetë të aftësive teknike, ose vjetrim të këtyre aftësive dhe njohurive nëse ato nuk përditësohen rregullisht krahas me zhvillimin e sektorit përkatës. Të kombinuara me papunësinë afatgjatë, përveç vjetërimit, këto aftësi mund të përkeqësohen edhe për shkak të përdorimit të pamjaftueshëm. Ndoshta kjo ka ardhur si rezultat i faktit që shumë prej punëtorëve të moshuar kanë hyrë në tregun e punës me kapital të ulët njerëzor dhe janë përpjekur shumë pak për të lehtësuar këtë situatë.

Për të dalë me një parashikim të mirë të përafërt në lidhje me nivelin e mbulimit të bizneseve, llogaritet përqindja e ndërmarrjeve të regjistruara në AKPA kundrejt totalit të ndërmarrjeve aktive në qark. Ky raport është një vlerësim i mirë i nivelit të tërheqjes së biznesit për t'u regjistruar në zyrën vendore të punësimin, e cila më pas mund të postojë vendet e lira të punës. Për vitin 2021, rreth 24% e ndërmarrjeve aktive janë aktualisht të regjistruara pranë zyrës vendore të punësimin në Elbasan. Kjo është një shifër e ulët për sa i përket mbulimit, por gjithsesi këtu duhet patur parasysh një faktor i rëndësishëm: shumica dërrmuese e ndërmarrjeve të regjistruara në bujqësi janë fermerë individualë, gjë që përbën prirje në rënie për vlerësimin. Pra, për të dhënë një vlerësim më të saktë ne duhet të përjashtojmë sektorin e bujqësisë. Me përjashtim të bujqësisë, rreth 43% e ndërmarrjeve aktive janë të regjistruara në zyrën vendore të punësimin. Për sa kohë që nuk ndryshon tipologjia e sektorit të bujqësisë, rekomandohet që të fokusohemi pikërisht në këtë vlerësim si pikë referimi dhe të kryejmë monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së mbulimit të bizneseve. Megjithatë, shifra vazhdon të jetë e vogël, pasi më pak se gjysma e ndërmarrjeve janë të regjistruara në zyrat vendore të punësimin.

Figura 21: Përqindja e ndërmarrjeve të regjistruara në AKPA kundrejt totalit të ndërmarrjeve aktive në qark



Burimi: AKPA (2021); INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA

Krahasimi i punëkërkuessve të papunë të regjistruar dhe i vendeve të lira të punës të regjistruara nxjerr në pah një hendek të madh, ku punëkërkuessit e regjistruar të papunë janë dukshëm më të shumtë në numër. Rezultatet flasin për një mbulim të ulët të ofertës së punës kur merren parasysh shifrat e zyrave të punësimit.

Në vitin 2020 pranë zyrave të punësimit janë regjistruar 10,672 të papunë dhe vetëm 2,745 vende të lira pune, shifër kjo që flet për ofertën shumë më të lartë të krahut të punës krahasuar me kërkesën. Me fjalë të tjera, vendet e lira të punës plotësojnë vetëm 26% të ofertës së fuqisë punëtore. Vendet e lira të punës të regjistruara kanë patur një rritje të qëndrueshme dhe të ndjeshme nga viti 2016 në 2018, përkatësisht 1,521 dhe 6,339 vende pune. Ndërsa, të papunët e regjistruar kanë pësuar një rënie nga viti 2016 në vitin 2018, duke e bërë vitin 2018 vitin kur u plotësua 70% e ofertës së fuqisë punëtore. Ky trend ka pësuar rënie nga viti 2018 në vitin 2020, duke e kthyer vitin 2020 në vitin më pak të favorshëm për sa i përket përafrimit të kërkesës dhe ofertës së punës.


Përveç këtij ekuilibri të dobët, një arsye tjetër që ka kontribuar në krijimin e kësaj situatë është mospërputhja e madhe midis vendeve të lira të punës dhe aftësive të punëkërkuessve – gjë që e përkeqëson situatën edhe më tej. Në përgjithësi, kërkesa për krah pune është më e lartë për profesionet me kualifikim të mesëm dhe të ulët.⁴ Përveç kësaj, kërkesa për punëtorë të kualifikuar (kryesisht duke iu referuar punëtorëve me arsim të lartë) është e ulët, vetëm një pjesë e vogël e ndërmarrjeve kërkojnë të punësojnë menaxherë, profesionistë dhe teknikë. Sipas raportit vjetor të AKPA-s për vitin 2019, kërkesa për fuqi punëtore fokusohet më shumë në kategorinë e zejtarëve me 30% të totalit të vendeve të lira të shpallura, ndërkohë që oferta mbulon 15% të totalit të të papunëve të regjistruar.⁵ Punëkërkuessit e papunë që nuk kanë asnjë lloj aftësie për punë, përbëjnë 19% të regjistrimit të punëkërkuessve,⁶ duke çuar kështu në diferencë të mëdha kur bëhet fjalë për vendet e lira të punës që kërkojnë punonjës me aftësi specifike.

⁴ Banka Botërore, *Demand for Skills in Albania: An Analysis of the Skills Towards Employment and Productivity Survey*, (Kërkesa për Aftësi në Shqipëri: Analiza e Studimit të Aftësive drejt Punësimit dhe Produktivitetit) 2018.

⁵ Raporti vjetor i AKPA-s, 2019

⁶ Raporti vjetor i AKPA-s, 2019


Figura 22: Punëkërkesit e papunë të regjistruar kundrejt vendeve të lira të punës të regjistruara



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Duke vëzhguar aktivitetin ekonomik ku janë përqendruar vendet e lira të punës, të dhënat tregojnë se qarku i Elbasanit është i fokusuar më shumë në prodhimin e mallrave sesa tek shërbimet. Gjatë pesë viteve të fundit është vënë re një çekuilibër i dukshëm në treg, për shkak të trendit të vazhdueshëm në rritje për prodhuesit e mallrave, dhe trendit të vazhdueshëm në rënie për prodhuesit e shërbimeve. Në vitin 2019 është regjistruar një luhatje dhe ndryshim i trendit sa i përket këtyre dy aktiviteteve ekonomike. Prodhimi i mallrave ka pësuar rënie me 12 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2018, ndërsa prodhuesit e shërbimeve janë përballur me një rritje prej 12 përqind në vitin 2019 (32%) në krahasim me vitin 2018 (20%). Sipas AKPA-s, në vitin 2020 është rikthyer trendi në rritje i prodhuesve të mallrave, duke arritur nivelin e tij më të lartë në masën 80%. Nga ana tjetër, prodhuesit e aktivitetit të shërbimeve kanë rënë në 20%. Kjo është situatë e pritshme për shkak të efekteve të pandemisë COVID-19. Prioritetet e konsumatorit u përqendruan tek nevojat bazë, duke paraqitur kërkesa për mallra në vend të aktiviteteve të shërbimeve, të cilat gjithsesi ishin të kufizuara ose të pezulluara për një periudhë të gjatë.


Figura 23: Vendet e lira të punës sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Nëse i analizojmë më thellë vendet e lira të punës të shpallura nga prodhuesit e mallrave, mund të themi se prodhimi është industria mbizotëruese, e cila ka spikatur në mënyrë të vazhdueshme gjatë pesë viteve të fundit. Megjithatë, në vitin 2019 dhe 2020 është regjistruar një rritje e lehtë e industrisë së ndërtimit krahasuar me vitet e mëparshme. Për sa i përket industrisë minerare dhe nxjerrëse, oferta e saj në aspektin e vendeve lira të punës rezulton e konsiderueshme vetëm në vitin 2020, me 3%. Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në rajon i cili përfaqëson 40% të PBB-së dhe shumica e aktiviteteve në bujqësi janë aktivitete të vogla familjare. Megjithatë, kur bëhet fjalë për punësimin, ky sektor angazhon kryesisht punëtorë të papaguar dhe të vetëpunësuar informalë.

Figura 24: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e Mallrave




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Nëse i hedhim një sy më nga afër industrisë së prodhimit, vëmë re që produktet ushqimore, pijet dhe produktet e duhanit zënë pjesën më të madhe të vendeve të lira të punës. Sipas të dhënave të AKPA-s, periudha kohore që shtrihet nga viti 2018 deri në vitin 2020 është karakterizuar nga një tendencë e dukshme në rritje në këtë drejtim, prej 21 pikë përqindjeje. Gjithashtu, sipas të dhënave, përpunimi i tekstit, veshmbathja dhe aktivitetet e prodhimit të lëkurës mbajnë vendin e dytë sa i takon vendeve të lira të punës në industrinë prodhuese. Krahasuar me vitet e mëparshme në vitin

2020 është regjistruar një rënie e lehtë prej 28 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2018 kur kjo ofertë kishte arritur kulmin saj në masën 60%.


Figura 25: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e mallrave: Prodhimi



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Pjesa më e madhe e vendeve të lira të punës tek prodhuesit e veprimtarive të shërbimeve, krijohen në formën e veprimtarive administrative dhe të shërbimeve mbështetëse. Të dhënat e tre viteve të fundit nuk flasin për pothuajse asnjë ndryshim në këtë drejtim. Megjithatë, gjatë tre viteve të fundit duket se tregtia ka patur një rritje të lehtë, duke u kthyer në ofruesin e dytë më të rëndësishëm të vendeve të punës brenda kësaj strukture. Përmirësimi i lidhjes me Tiranën nëpërmjet rrugës Elbasan-Tiranë mund të ketë dhënë kontributin e saj në rritjen e aktiviteteve tregtare, duke u përkthyer kështu në më shumë vende të lira pune në këtë sektor. Gjithashtu, akomodimi dhe shërbimi ushqimor janë një sektor i paqëndrueshëm për sa i përket vendeve të lira të punës, pasi kanë shfaqur luhatje ndër vite. Në vitin 2020, rreth 9% e vendeve të lira të punës nga prodhuesit e shërbimeve siguroheshin nga aktivitetet e akomodimit dhe shërbimeve ushqimore, me një diferencë prej 6 p.p në krahasim me vitin 2019. Megjithatë, pandemia e COVID-19 mund të përdoret si një shpjegim i pranueshëm i këtyre dallimeve.

Figura 26: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e Shërbimeve




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Sa i takon aktiviteteteve të tjera, vetëm disa prej tyre kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në numrin e vendeve të lira të punës të regjistruara. Përveç tre aktiviteteteve kryesore ku është deklaruar shumica e vendeve të lira të punës nga prodhuesit e shërbimeve, në Figurën 27 tregohet se kontributi i transportit dhe magazinimit në kërkesën për punë është në masën 7%.

Pritet që prodhuesit e aktiviteteteve të shërbimeve të kenë më shumë vende të lira pune për punonjës me nivel më të lartë arsimor dhe të pajisur me aftësi të shumta, por tek të dhënat, këto aktivitete kanë një peshë shumë të vogël në vendet e lira të punës të regjistruara në zyrën rajonale të punësimit. Kategoritë e tilla përfshijnë aktivitetet financiare dhe të sigurimit (2%), aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (2%), aktivitetet që lidhen me shëndetin e njeriut dhe punën sociale (2%), informacioni dhe komunikimi (1%). Prandaj, të dhënat sugjerojnë se vendet e lira të punës të regjistruara kërkojnë persona me aftësi rutinë manuale dhe jo persona me aftësi që lidhen me nivelet e arsimit të lartë, si aftësitë e 'buta' ndërpersonale, aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe për të ndërvepruar me të tjerët.

Figura 27: Vendet e lira të punës – Prodhuesit e Shërbimeve, të detajuara për vitin 2020




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Duke i analizuar më thellë aftësitë e nevojshme për të plotësuar vendet e lira të punës në rajon, ajo që të bie në sy në 5 vitet e fundit janë aftësitë e zejtarëve dhe të profesioneve të ngjashme. Në vitin 2020 kjo kërkesë arriti kulmin me 74% të vendeve të lira të punës. Profesionet elementare, që përbëhen nga detyra të thjeshta dhe rutinë, të cilat kryesisht kërkojnë përdorimin e veglave të dorës dhe shpesh punë fizike, janë profesionet e dyta më të kërkuara.

Fuqia punëtore me arsim të lartë pritet të ketë një shkallë më të lartë papunësie, e cila mund të vijë edhe si rezultat i kërkesës më të ulët për fuqi punëtore të kualifikuar. Në vitin 2020, vetëm 2% e vendeve të lira të punës kërkonin aftësi të specializuara të nivelit të arsimit të lartë dhe vetëm 6% kërkonin teknike dhe specialistë me arsim të mesëm. Në vitin 2019 këto shifra ishin pak më të larta, tregu i vendeve të lira të punës kërkonte fuqi punëtore më të kualifikuar. Megjithatë, në industri janë vënë re shifra të ulëta të vendeve të lira të punës, me një rënie prej 7 pikë përqindjeje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Edhe pse industria është aktiviteti i dytë kryesor ekonomik në rajon, ajo nuk kontribuon aq shumë në ofertën e vendeve të lira të punës.


Figura 28: Vendet e lira të punës sipas profesionit



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Mospërputhja e aftësive është hendeku midis aftësive që ofrohen nga punëtorët dhe aftësive që kërkohen nga bizneset. Krahasimi i vendeve të lira të punës dhe i të papunëve të regjistruar sipas profesionit ofron një tablo të mirë në lidhje me mospërputhjet e mundshme të aftësive në tregun e punës. Rezultatet tregojnë se për vitin 2020, çdo vend i lirë pune i kategorizuar sipas profesionit përputhet dhe tejkalohet nga të papunët e regjistruar në të njëjtën kategori për secilën prej kategorive.

Figura 29: Vendet e lira të punës kundrejt të papunëve të regjistruar sipas profesionit në vitin 2020




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Gjatë eksplorimit të mëtejshëm të nënkategorive, na shfaqet vetëm një nënkategori ku numri i vendeve të lira të punës është më i lartë sesa numri i të papunëve të regjistruar: konkretisht këtu bëhet fjalë për zejtarët që përpunojnë ushqime, dru, tekstile, etj., brenda kategorisë "zejtarët dhe profesione të ngjashme". Kjo nënkategori ofron 1,734 vende të lira pune, ndërkohë që numri i të

papunëve të regjistruar me këtë profesion është vetëm 1,053. Prandaj, mospërputhja e aftësive nuk është një problematikë e përhapur në tregun e punës. Ky fenomen duket mjaft specifik për këtë nënkategori edhe kur merren parasysh të dhënat e 5 viteve të fundit.


Figura 30: Vendet e lira të punës kundrejt të papunëve të regjistruar për nënkategorinë “zejtarë që përpunojnë ushqime, dru, tekstile, etj”



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Programet e nxitjes së punësimit janë si një fanar që shërben për të ndihmuar disa kategori të punëtorëve me kualifikim më të ulët për të hyrë dhe për të përparuar në vendin e punës, por ato janë zakonisht të vogla dhe të përshtatura për grupime më të ngushta punëtorësh dhe aftësish, gjë që mund ta bëjë të vështirë përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës. Ndër vite politikëbërësit në Shqipëri kanë zhvilluar disa programe për nxitjen e punësimit, të përshtatura për të adresuar nevojat imediate të tregut të punës ose për të synuar grupe të veçanta të pafavorizuara. Sipas të dhënave të AKPA-s për qarkun, viti 2017 regjistroi numrin më të madh të pjesëmarrjeve në programet e nxitjes së punësimit, me 456 pjesëmarrës. Megjithatë, katër vitet pasuese u shoqëruan nga një tendencë e vazhdueshme në rënie, ku viti 2020 ishte viti “më i keq” në këtë aspekt pasi vetëm 113 persona morën pjesë në këto programe. Një arsye për këtë rënie të vazhdueshme mund të lidhet me faktin që këto programe nuk kanë ndikim real të konsiderueshëm mbi treguesit e punësimit.


Figura 31: Pjesëmarrësit në programet e nxitjes së punësimit



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Një burim i konsiderueshëm i punëtorëve të kualifikuar në rajon janë të diplomuarit e programeve të AFP-së. Numri i përgjithshëm i të diplomuarve në AFP është disi më i qëndrueshëm se sa fuqia punëtore nga programet e nxitjes së punësimit. Megjithatë, në krahasim me vitin 2016 është vënë re një tendencë në rënie, e cila është thelluar edhe më shumë në vitin 2017 dhe 2018.

Figura 32: Totali i të diplomuarve të AFP-së




Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Shënim: Të dhënat më të fundit në dispozicion datojnë në vitin 2019.

Duke marrë parasysh vitin e fundit, të diplomuarit e AFP-së ndjekin studimet në një sërë programesh të ndryshme. Shumica e maturantëve kanë përfunduar programin për shërbimin e mjeteve të transportit, pasuar nga shërbimi i hotelierisë dhe turizmit dhe elektrikistët. Ndonëse të pranishme, disa profesione kyçe kanë një numër të ulët të diplomuarish, si p.sh. drejtimi i “tekstilit dhe veshjeve” – ku megjithëse kërkesa për këtë profesion është e madhe, numri i të diplomuarve është mjaft i vogël. Studimi gjurmues i kryer nga AKPA tregon se, përveç vazhdimit të shkollimit, shumica e të diplomuarve janë të punësuar.⁷ Gjatë konsultimeve me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit dhe Formimit Profesional në Elbasan, u konfirmua se punësueshmëria e të diplomuarve kishte ardhur si rezultat i nivelit të duhur të aftësive të tyre dhe kërkesës së tregut. Ndonëse jo të jashtëzakonshme, përmirësimet në programet e AFP-së kanë rritur nivelin e aftësive të pjesëmarrësve, një element kyç për punësueshmërinë e tyre, ndërkohë që nevojiten shumë më tepër përmirësime në infrastrukturë për të tejkaluar nivelin e tyre.

Figura 33: Të diplomuarit e AFP-së sipas llojit të programit (2019)



Burimi: AKPA (2021); Analiza e kryer nga IDRA.


Shënim: Të dhënat më të fundit në dispozicion datojnë në vitin 2019.

⁷ AKPA, Informacion mbi ofertën e AFP-së për Qarkun e Elbasanit, gusht 2021.

4 Analizë e Detajuar Sektoriale

Panorama e përgjithshme e rritjes rajonale paraqet rezultate të përziera dhe mungesën e një tendence të qartë zhvillimi, duke demonstruar kështu një ekonomi vendore të brishtë. Politikat e zhvillimit rajonal, të hartuara nga qeveria krahas investimeve të huaja, nuk duket se kanë ndonjë ndikim në rritjen ekonomike të rajonit. Të dhënat në lidhje me normën e rritjes rajonale nga viti 2014 në vitin 2019 (Figura 34) paraqesin një luhatje në vitin 2015, me një rënie të PBB-së në -4.6%. Rritja relativisht e lartë në vitin 2016 (4.4%) balancon disi rënie të mëparshme dhe rritja e mëpasme është e rastësishme duke mos lënë prapa një model të qartë. E kombinuar edhe me të dhënat specifike të sektorit (Figura 35), në asnjë prej sektorëve kontribues në PBB nuk është regjistruar ndonjë rritje e qëndrueshme dhe e konsiderueshme për të mbështetur këtë situatë të rritjes së ulët ekonomike në rajon. Faktorë të tjerë ekonomikë që kanë kontribuar kryesisht në ekonominë e brishtë të Elbasanit, janë shkalla e lartë e papunësisë dhe mungesa e krijimit të qëndrueshëm të vendeve të punës. Zhvillimi në tregun e punës, veçanërisht sa i takon kërkesës, është ndikuar në një masë të madhe nga kjo ecuri e dobët.

Figura 34: Norma e Rritjes së PBB-së Rajonale (%) 2014 - 2019




Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Shënim: Vlerësimi për vitin 2019 është bazuar në vlerësimin gjysmëfinal të PBB-së nga INSTAT.

Duke marrë parasysh faktorët ndikues kryesorë në PBB-në e qarkut të Elbasanit, në vitin 2019 bujqësia, pyjet dhe peshkimi rezultuan të jenë kontribuuesit kryesorë me 40%, ndjekur nga industria me 15%. Aktivitetet e administratës publike dhe tregtia me shumicë kanë pothuajse të njëjtin ndikim me 14% në PBB-në e Elbasanit.

Duke iu referuar figurës 35, të dhënat sugjerojnë se gjatë 5 viteve të fundit (2014-2019) nuk janë regjistruar ndryshime të konsiderueshme në të gjitha aktivitetet e strukturës së PBB-së. Prandaj, sektorët kryesorë kontribues nuk kanë patur ndonjë ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e rajonit. Aktivitetet bujqësore kanë pësuar vetëm një rritje prej 0.7 pp në vitin 2019 krahasuar me vitin 2014, përkatësisht 40.2% dhe 39.5%. Nga viti 2014 deri në vitin 2019, aktivitetet e industrisë dhe të administratës publike kanë patur relativisht të njëjtën rritje, përkatësisht 2.5 pp dhe 2.2 pp. Kontributi i sektorit industrial për ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme është i madh, por kur sektori industrial i një rajoni nuk ka zhvillim të konsiderueshëm, atëherë edhe ekonomia e atij rajoni nuk njej rritje. Aktivitetet e ndërtimit regjistruan një rritje me 1.4 pp, nga 7% në vitin 2014 dhe 5.6% në vitin 2019. Megjithatë, aktivitetet e tregtisë me shumicë kanë pësuar një rënie me 1.9 pp sa i takon kontributit të tyre në PBB.

Figura 35: Struktura e PBB-së në Elbasan 2014-2019 (në %)




Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Shënim: Vlerësimi për vitin 2019 është bazuar në vlerësimin gjysmëfinal të PBB-së nga INSTAT;

*Kategoria “Të tjera” përfshin komunikacionin, aktivitetet financiare dhe sigurimet, aktivitetet profesionale, shkencore, teknike, administrative dhe shërbime të tjera mbështetëse, shërbime të tjera.

Duke parë numrin e ndërmarrjeve aktive në 5 vitet e fundit, bie në sy rritja e papritur në vitin 2016 prej 15.7%. Kjo rritje i atribuohet regjistrimit zyrtar si biznese të veprimtarive bujqësore dhe blegtorale. Bujqësia dhe politika e zhvillimit rural kanë pësuar rregullime të vazhdueshme në aspektin e harmonizimit institucional dhe politik me politikën e përbashkët bujqësore të BE-së. Në fund të vitit 2014 Shqipëria krijoi një kuadër të ri strategjik për zhvillimin e ardhshëm të zonave bujqësore dhe rurale (Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (SNBZHR) 2014–2020). Vitet pasuese (2017-2020) u karakterizuan nga ndryshime të vogla ose nga asnjë ndryshim i rëndësishëm në aspektin e shifrave; megjithatë, tendenca e përgjithshme është në rritje, ku ndërmarrjet aktive u rritën me 4.5% nga viti 2016 në 2020.


Figura 36: Numri i ndërmarrjeve aktive në Elbasan (2015 – 2020)



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Shpërndarja e punësimit ndërmjet ndërmarrjeve në sektorin e biznesit është reflektim i disa faktorëve, si struktura industriale në një vend, madhësia e tij ekonomike dhe hapja e tregut. Evoluimi i kësaj shpërndarjeje me kalimin e kohës dhe në të gjithë universin heterogjen të ndërmarrjeve është i dobishëm për vlerësimin e potencialit bazë që ekziston brenda një ekonomie për të gjeneruar rritjen e punësimit. *Gjatë 5 viteve të fundit, nuk janë vënë re ndryshime të dukshme të ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë në qarkun e Elbasanit.* Për t'u theksuar është fakti se ndërmarrjet e mëdha me mbi 50 punonjës janë rritur, nga 69 në vitin 2015 në 89 në vitin 2020. Pësha e ndërmarrjeve me rritje të lartë midis të gjitha ndërmarrjeve aktive me të paktën 4 punonjës, është rritur vetëm me 1pp nga viti 2015 deri në vitin 2020. Përkthyer në numër ndërmarrjesh, në vitin 2015 rajoni regjistronte 10,693 ndërmarrje me 1-4 punonjës dhe 13,906 në vitin 2020. Në të kundërt, pësha e ndërmarrjeve me 5-9 punonjës ka rënë, nga 423 në vitin 2015 në 375 ndërmarrje në vitin 2020.

Figura 37: Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë (2015 – 2020)



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Duke parë ndarjen sipas aktivitetit ekonomik, në vitet e fundit ndërmarrjet me rritje të lartë ishin më mbizotëruese në rradhët e prodhuesve të mallrave. Gjatë 5 viteve të fundit është vënë re një tendencë e vazhdueshme në rritje, ku ndërmarrjet aktive të prodhuesve të mallrave e kanë dyfishuar peshën e tyre në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, nga 28% në vitin 2015 në 52% në vitin 2020. Për shkak të regjistrimit masiv si biznese të vogla të veprimtarive bujqësore dhe blegtorale në kuadër të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, viti 2016 përkon me një rritje të ndjeshme të aktiviteve bujqësore. Aktivitetet e regjistruara patën përfitime ekonomike nga qeveria dhe programet e huaja zhvillimore. Megjithatë, aktivitetet e industrisë kanë përjetuar nga viti 2015 deri në vitin 2020 një tendencë në rënie me 3 pikë përqindjeje. Sidoqoftë, prodhuesit e shërbimeve, me të gjitha aktivitetet e përfshira, janë përballur me një tendencë të vazhdueshme në rënie nga 72% në vitin 2015 në 48% në vitin 2020.

Tabela 1: Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas aktivitetit ekonomik (2015 – 2020)


Lloji i Aktivitetit	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Prodhuesit e Mallrave	28%	38%	42%	47%	50%	52%
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	18%	30%	34%	38%	42%	45%
Industria	9%	7%	7%	7%	6%	6%
Ndërtimi	2%	1%	1%	2%	2%	2%

Lloji i Aktivitetit	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Prodhuesit e Shërbimeve	72%	62%	58%	53%	50%	48%
Tregtia	34%	28%	26%	25%	23%	22%
Transporti dhe magazinimi	6%	5%	4%	4%	4%	4%
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	17%	15%	14%	13%	12%	11%
Informacioni dhe komunikimi	1%	1%	1%	1%	1%	1%
Shërbime të tjera	13%	12%	12%	11%	11%	11%

Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Krahasimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe llojit të aktivitetit nxjerr në pah vetëm një tendencë të dukshme në perspektivën e përzgjedhur, që ka të bëjë me mbizotërimin e prodhuesve të mallrave në ndërmarrjet me 1-4 të punësuar – që siç u diskutua më parë vjen nga regjistrimi i fermerëve individualë. Në vitin 2020, prodhuesit e shërbimeve përfaqësonin 74% të ndërmarrjeve me 5-9 punonjës, ndërsa prodhuesit e mallrave 26% të tyre. Njëkohësisht, në vitin 2020, për ndërmarrjet me 10-49 punonjës, prodhuesit e shërbimeve përfaqësonin 62% të tyre krahasuar me 38% të prodhuesve të mallrave. E njëjta tendencë por me një hendek të ngushtuar shfaqet edhe për ndërmarrjet e mëdha me mbi 50 të punësuar, 55% e prodhuesve të shërbimeve kontribuojnë në këto aktivitete, krahasuar me 45% të prodhuesve të mallrave. Të dhënat që burojnë nga analizimi i trendeve të viteve të shkuara nuk flasin për ndonjë luhatje të konsiderueshme në kategoritë e tjera, përveç se në ndërmarrjet mikro. Për ndërmarrjet me 1-4 punonjës, në vitin 2015 peshën më të madhe e kanë prodhuesit e shërbimeve me 72%. Sekuenca ka patur një tendencë të vazhdueshme në rënie, duke zbritur në masën 47% në vitin 2020. E kundërta ka ndodhur me prodhuesit e mallrave për sipërmarrjet e vogla me 1-4 punonjës, nga 28% e peshës në vitin 2015, është rritur në 53% në vitin 2020.

Figura 38: Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik (2015 – 2020)



Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Për të eksploruar më tej dinamikën e ndërmarrjeve në rajon, këtu ne bëjmë një analizë të 20 kategorive kryesore sipas numrit të ndërmarrjeve, bazuar në formularin e klasifikimit 2-shifror NACE të INSTAT-it. Është e dukshme se gjatë viteve të fundit vetëm disa kategori kanë shënuar rritje, ndërsa në shumicën e kategorive është vënë re një rënie e numrit të ndërmarrjeve aktive. Në veçanti: Prodhimi i bimëve dhe kafshëve, gjuetia dhe aktivitetet e shërbimeve përkatëse (që përfshin rritjen për shkak të regjistrimit të fermerëve), aktivitetet e shëndetit të njeriut, aktivitetet e specializuara ndërtimore, aktivitetet ndihmëse për shërbimet financiare dhe aktivitetet e sigurimit, aktivitetet sportive dhe aktivitetet zbavitëse dhe rekreative, si dhe aktivitetet edukative kanë qenë në rritje. Duke marrë parasysh aktivitetet në rritje, ekonomia vendore nuk përshkohet nga një model i qartë zhvillimi.

Nga ana tjetër, këtu mund të përmendim edhe disa aktivitete të tjera të rëndësishme që kanë pësuar rënie sa i takon numrit të ndërmarrjeve, si tregtia dhe prodhimi. Për të analizuar situatën, marrim në konsideratë teorinë moderne të specializimit të sektorit, sipas të cilës ekonomitë vendore mund të përballen me diversifikim të tepërt në momentin kur këto sektorë zbulojnë produktet më të favorshme për të cilat duhet të specializohen. Në këtë rast, politika duhet të orientohet në sektorin modern në fazën e zbulimit.⁸ Për më tepër, politika duhet në disa raste të punojë për të racionalizuar prodhimin më pas, duke inkurajuar lëvizjen nga aktivitetet me kosto më të lartë drejt aktiviteteve me kosto më të ulët, duke i reduktuar industritë në ato me më shumë

⁸ Hausmann, R., Rodrik, D., Benavente, J. M., & Rodríguez, F. (2005). *Self-Discovery in a Development Strategy for El Salvador* (Vetë-Zbulimi në Strategjinë e Zhvillimit për El Salvadorin [me komente]. *Economía*, 6(1), 43-101.

potencial për ekonominë. Në këtë nivel të zërthimit të të dhënave, është e vështirë të përdoret një metodologji e tillë për të përcaktuar ndonjë model të vërtetë specializimi – vlerësimi i situatave të tilla kërkon të dhëna në nivel biznesi. Megjithatë, këto të dhëna nuk i zbulojnë mundësitë e tilla për specializimin (duke marrë parasysh shkallën e vogël, pronësinë familjare, tipologjinë e aktiviteteve bujqësore.)

Tabela 2: 20 ndërmarrjet kryesore aktive të mëdha sipas llojit të aktivitetit - NACE 2 shifror, renditur sipas madhësisë në vitin 2020 (2015 – 2020)

Lloji i Aktivitetit	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Rritja
Prodhimi i bimëve dhe kafshëve, gjuetia dhe aktivitetet e shërbimit të ngjashme me to	2,009	3,906	4,402	5,111	5,634	6,171	207%
Tregtia me pakicë, me përjashtim të mjeteve motorike dhe motoçikletave	3,159	3,099	2,854	2,682	2,476	2,392	-24%
Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve	1,931	1,971	1,834	1,652	1,502	1,451	-25%
Transporti tokësor dhe transporti nëpërmjet tubacioneve	706	660	576	512	480	484	-31%
Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	344	337	327	325	310	326	-5%
Tregtia me shumicë, me përjashtim të automjeteve dhe motoçikletave	373	350	315	303	291	307	-18%
Aktivitetet e tjera të shërbimit personal	341	352	338	309	287	301	-12%
Prodhimi i produkteve ushqimore	337	348	334	313	304	286	-15%
Aktivitetet e shëndetit të njeriut	215	231	239	244	251	259	20%
Aktivitetet ligjore dhe kontabël	172	168	166	159	157	164	-5%
Riparimi i kompjuterëve dhe i mallrave personale dhe shtëpiake	180	183	180	175	169	154	-14%
Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	131	124	124	119	120	107	-18%
Aktivitetet e specializuara ndërtimore	68	71	69	84	84	103	51%
Ndërtimi i objekteve	116	93	83	83	84	82	-29%
Prodhimi i mobiljeve	73	73	72	73	65	71	-3%
Arsimi	68	66	62	66	67	69	1%
Veprimtaritë e organizatave me anëtarësi	74	86	70	77	75	66	-11%
Aktivitetet ndihmëse të shërbimeve financiare dhe aktiviteteve të sigurimit	40	44	48	50	58	64	60%
Aktivitetet sportive dhe aktivitetet zbavitëse dhe rekreative	55	66	61	56	57	58	5%
Prodhimi i drurit dhe i produkteve prej druri dhe tape, përveç mobiljeve; prodhimi i artikujve prej kashte dhe materialeve të thurjes	95	89	78	68	64	57	-40%

Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.

Një tjetër qasje për parashikimin e aftësive është analizimi i aktiviteteve me rritje më të lartë në vitet e fundit. Aktivitetet që po rriten me shpejtësi (dhe janë të konsiderueshme) përfaqësojnë perspektivat e ardhshme për sa i përket kërkesës së tregut të punës.⁹ “Prodhimi i tekstileve” shfaqet si me rritje më të shpejtë (+110% nga viti 2015), ndonëse me vetëm 11 kompani më shumë në terma relativë. E kombinuar me vendet e lira të punës për “zejtarët që përpunojnë ushqime, dru, tekstile”, kjo kategori është një nga më të spikaturat për krijimin e vendeve të reja të punës në rajon. Aktivitete të tjera përfshijnë: “minierat dhe industrinë nxjerrëse”; “aktivitetet ndihmëse për shërbimet financiare dhe aktivitetet e sigurimit”; “aktivitetet e specializuara të ndërtimit”; “programimi kompjuterik, konsulenca dhe aktivitete të ngjashme”; “inxhinieria civile” dhe “akomodimi”.

Tabela 3: 20 sipërmarrjet aktive me rritjen më të lartë sipas llojit të aktivitetit - NACE 2-shifror, renditur sipas rritjes 5 vjeçare (2015 - 2020)

Lloji i Aktivitetit	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Rritja
Prodhimi i tekstileve	10	8	9	7	6	21	110%
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimet shoqërore të detyrueshme	20	49	49	49	50	41	105%
Aktivitetet e tjera minerare dhe të industrisë nxjerrëse	26	26	24	34	56	49	88%
Aktivitetet për dhënie/marrjen me qira dhe leasing	7	6	6	7	12	13	86%
Shërbimet për ndërtesat dhe aktivitetet e mirëmbajtjes	5	7	8	9	12	9	80%
Mbështetja administrative dhe aktivitete të tjera mbështetëse të biznesit	29	38	43	38	31	48	66%
Aktivitetet ndihmëse të shërbimeve financiare dhe aktiviteteve të sigurimit	40	44	48	50	58	64	60%
Aktivitetet e magazinimit dhe aktivitetet mbështetëse për transportin	7	8	5	10	10	11	57%
Aktivitetet e specializuara ndërtimore	68	71	69	84	84	103	51%
Programimi kompjuterik, konsulenca dhe aktivitete të ngjashme	31	36	33	38	41	46	48%
Aktivitetet veterinarë	7	6	7	5	6	10	43%
Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve (te paklasifikuara diku tjetër)	3	-	-	-	-	4	33%
Inxhinieria civile	26	35	43	40	37	34	31%
Mbledhja, trajtimi dhe furnizimi me ujë	7	9	9	8	7	9	29%
Akomodimi	45	51	47	50	57	57	27%
Agjenci udhëtimesh, shërbim rezervimi i operatorëve turistikë dhe aktivitete të ngjashme	28	28	32	41	36	35	25%

⁹ Qasja jonë është e kufizuar për shkak të mungesës së të dhënave për numrin e të punësuarve në këto ndërmarrje.

Lloji i Aktivitetit	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Rritja
Prodhimi i bimëve dhe kafshëve, gjuetia dhe aktivitetet e shërbimit të lidhura me to	2,009	3,906	4,402	5,111	5,634	6,171	21%
Aktivitetet e shëndetit të njeriut	215	231	239	244	251	259	20%
Aktivitetet e shërbimit të informacionit	5	7	4	6	4	6	20%
Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastike	7	6	6	6	6	8	14%

Burimi: INSTAT (2021); Analiza e kryer nga IDRA.


5 Tregu i Punës dhe Perspektivat e Zhvillimit

Kur analizohet kërkesa për fuqi punëtore, dy janë treguesit kryesorë që paraqesin zhvillimin makro të saj, strukturën vendore të PBB-së dhe strukturën e ndërmarrjeve në nivel vendor. Siç kemi diskutuar më parë, në Elbasan pjesa më e madhe e kontributit në PBB vjen nga bujqësia dhe ekonomia dominohet kryesisht nga ndërmarrjet e vogla bujqësore, të cilat me shumë gjasa janë familjare.

Duke patur parasysh këtë kontekst, zhvillimi i kërkesës për krah pune duhet të bazohet në **teorinë e ndryshimeve strukturore**. Teoria përshkruan mekanizmin me anë të të cilit ekonomitë e pazhvilluara i transformojnë strukturat e tyre ekonomike të brendshme duke e zhvendosur theksin nga bujqësia tradicionale si mjet jetese tek ekonomia e prodhimit dhe shërbimeve më moderne, më të urbanizuara dhe më të larmishme në aspektin industrial.¹⁰ Dy shembuj përfaqësues të mirënjohur të qasjes së ndryshimit strukturor janë analiza empirike e "suficitit të krahut të punës me dy sektorë",¹¹ dhe e "modeleve të zhvillimit".¹²

Në modelin e *suficitit të krahut të punës me dy sektorë*, ekonomia e pazhvilluar përbëhet nga dy sektorë: një sektor tradicional, i mbipopulluar, i mbijetesës rurale i karakterizuar nga produktiviteti marginal zero i krahut të punës - një situatë që e klasifikon këtë si punë të tepërt në kuptimin që mund të tërhiqet nga sektori tradicional i bujqësisë pa asnjë humbje prodhimi - dhe një sektor modern industrial urban me produktivitet të lartë, në të cilin krahu i punës nga sektori i mbijetesës transferohet në mënyrë graduale. Fokusi parësor i modelit është si në procesin e **transferimit të krahut të punës ashtu edhe në rritjen e prodhimit dhe punësimit në sektorin modern**. Si transferimi i punës ashtu edhe rritja e punësimit në sektorin modern shkaktohen nga zgjerimi i prodhimit në atë sektor. Shpejtësia me të cilën ndodh ky zgjerim përcaktohet nga shkalla e investimit dhe akumulimit të kapitalit në sektorin modern.

Figura 39: Skema e transferimit të forcës punëtore në dy sektorë



Burimi: Analiza e kryer nga IDRA.

¹⁰ Todaro, Michael P., dhe Stephen C. Smith. *Economic development*. (Zhvillimi ekonomik), Pearson, 2020.

¹¹ Lewis, W. Arthur. *Theory of economic growth*. (Teoria e rritjes ekonomike), Routledge, 2013.


¹² Chenery, H. B., & Taylor, L. (1968). *Development patterns: among countries and over time*. *The Review of Economics and Statistics*, (Modelet e zhvillimit: midis vendeve dhe me kalimin e kohës. Rishikimi i Ekonomisë dhe Statistikave), 391-416.

Modeli i "modeleve të zhvillimit" të ndryshimit strukturor fokusohet në procesin e njëpasnjëshëm përmes të cilit transformohet struktura ekonomike, industriale dhe institucionale e një ekonomie të pazhvilluar me kalimin e kohës për të lejuar zëvendësimin e bujqësisë tradicionale me industrinë e reja, si motori i rritjes ekonomike. Megjithatë, përveç akumulimit të kapitalit, fizik dhe njerëzor, për kalimin nga një sistem ekonomik tradicional në atë modern, nevojiten një sërë ndryshimesh të ndërlidhura në strukturën ekonomike të një vendi. Këto ndryshime strukturore përfshijnë pothuajse të gjitha funksionet ekonomike, si për shembull transformimi i prodhimit dhe ndryshimet në përbërjen e kërkesës së konsumatorit, tregtia ndërkombëtare dhe përdorimi i burimeve, si dhe ndryshimet në faktorët social-ekonomikë si urbanizimi dhe rritja dhe shpërndarja e popullsisë së një vendi.

Çështja e paraqitur është thelbësore për zhvillimin e tregut të punës në Elbasan. Nga të gjitha problematikat e tregut të punës, e para ka të bëjë me mungesën e kërkesës, ose mungesën e kërkesës "së duhur", siç iu referuam kërkesës për "sektorin modern". Kjo nuk nënkupton zhdukjen e bujqësisë. Përkundrazi, teknologjitë dhe novacionet e reja bujqësore që përdoren aktualisht janë duke i përmirësuar nivelet e prodhimit dhe produktivitetit. Meqenëse parcelat e tokës janë të vogla, kapitali është i pakët dhe fuqia punëtore (me kualifikim të ulët) është e bollshme, futja e teknikave të mekanizuara shumë shpesh nuk i përshtatet mjedisit fizik dhe ndikon në rritjen e papunësisë në nivel rural.

Ndryshimi strukturor mund të ndodhë përmes rritjes së industrive të vogla dhe me intensitet pune. Lloji i produktit ka efekte të dukshme në shtrirjen e mundësive të punësimit, sepse disa produkte (shpesh mallra bazë të konsumit) kërkojnë më shumë punë për njësi produkti dhe për njësi kapitali se të tjerët. Zgjerimi i industrive në fjalë mund të arrihet përmes investimeve dhe stimuljeve të qeverisë dhe përmirësimit të qasjes tek kreditë, veçanërisht për aktivitetet sipërmarrëse. Në një kontekst të tillë, sfida themelore e punësimit në nivel vendor është krijimi i vendeve të punës më cilësore dhe vënia e tyre në dispozicion të të gjithëve. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë, **politikat që mbështesin iniciativat sipërmarrëse** si mënyra për të mbështetur hapjen e vendeve të punës janë politikat më praktike të punësimit.

Figura 40: Efektet e perspektivës sipërmarrëse



Burimi: Analiza e kryer nga IDRA.

Analiza e detajuar e sektorit nuk zbulon asnjë sektor të veçantë (përveç bujqësisë dhe ndërtimit) që paraqet një model zhvillimi. Më tej, takimet e palëve të interesuara në Elbasan treguan se aktiviteti sipërmarrës është 'i fjetur' dhe më së shumti i fokusuar në aktivitete mikro në fusha të tilla si turizmi, bujqësia dhe artizanati. Palët e interesuara pohojnë se migrimi i brendshëm i

profesionistëve të kualifikuar drejt Tiranës, ose aftësia e tyre, për shkak të distancës së shkurtër, për të punuar në Tiranë, po ndikon në mjedisin sipërmarrës në Elbasan – duke e lënë atë të amullt dhe të pazhvilluar. Disa politika për nxitjen e sipërmarrjes përfshijnë: (i) qasjen tek financimet; (ii) inkurajimin e rrjeteve të biznesit ndërmjet sipërmarrësve aspirantë dhe mentorëve të biznesit, si p.sh. nëpërmjet ekosistemeve të *startup*-eve; (iii) sigurimin e edukimit për sipërmarrjen të bazuar në gjenerata, duke përfshirë skemat e zhvillimit të sipërmarrjes së të rinjve që përshtaten me nevojat e veçanta të brezit mijëvjeçar.

Një fokus i veçantë i aktiviteteve sipërmarrëse dhe i ndërmarrjeve të vogla është **rritja e pjesëmarrjes në ekonominë digjitale**. Tregtia elektronike (*e-commerce*) dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) rrit shitjet mesatare të ndërmarrjeve, i ndihmon ato të kapin tregje të reja përtej shtrirjes së tyre lokale dhe i bën bizneset e tyre më konkurruese në nivel kombëtar. Përdorimi i zgjidhjeve nëpërmjet këtyre platformave për transaksionet *online* biznes me biznes dhe për shkëmbimet elektronike me transaksionet e qeverisë redukton në mënyrë drastike kostot dhe përmirëson mundësitë e tregut—por së pari nevojitet kapërcimi i disa sfidave thelbësore në aspektin e politikave.

Përveç kësaj, **ekonomia informale** vazhdon të mbetet një veçori strukturore në rajon dhe ka qenë e tillë ndër vite. Duke pasur parasysh mungesën e mundësive formale të punësimit, punësimi informal është për shumë persona një strategji mbijetese në kushtet e varfërisë. Megjithatë, në këtë aspekt duhet bërë më shumë për të lehtësuar formalizimin e tyre, duke përfshirë një gamë të gjerë masash si stimujt financiarë, rishikimi i inspektimeve të punës dhe mundësitë e trajnimit për punëtorët informalë. Sektori informal karakterizohet nga një numër i madh aktiviteteve prodhimi dhe shërbimi në shkallë të vogël që janë në pronësi individuale ose familjare, dhe që janë të thjeshta dhe me intensitet pune. Reforma e re tatimore “fiskalizimi” do të shërbejë si një gur themeli për përshpejtimin e formalizimit të sektorit të biznesit. Megjithatë, politika duhet të shoqërohet edhe me stimuj fiskalë për bizneset që shkojnë përtej dhe bëjnë një parashikim të qartë të përfitimeve në të ardhmen.

Kapitali njerëzor përcaktohet kryesisht nga edukimi që merr individi, megjithëse i ndikuar nga shumë faktorë që nuk kanë lidhje me tregun, dhe mund të konsiderohet si i përcaktuar kryesisht nga kërkesa dhe oferta. Nga ana e kërkesës, dy faktorët kryesorë që ndikojnë në nivelin e arsimimit janë: (i) të ardhurat e ardhshme nëpërmjet punësimit, dhe (ii) kostot arsimore, direkte dhe indirekte. **Nga ana e ofertës, sasia e kuotave shkollore në nivelet 9-vjeçare, të mesme dhe universitare përcaktohet kryesisht nga procesi i politikave arsimore, dhe ndoshta në rastin e Shqipërisë nuk udhëhiqet nga ndonjë kriter tregu.** Në pjesën e mëparshme diskutuam në lidhje me mënyrën se si kërkesa mund të ndikojë në transferimin e punës. Megjithatë, edhe ndikimi i ofertës në këtë aspekt është i madh. Politikat arsimore duhet të shkrihen me politikat e punësimit për të reaguar në një plan më afatgjatë ndaj zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor përmes AFP-së dhe niveleve më të larta është një komponent thelbësor i sistemit arsimor. Kombinimi i qasjes "nga lart poshtë" me qasjen "nga poshtë lart" është i nevojshëm për ta arritur këtë. Programet që janë më pak relevante dhe me norma më të ulëta punësimi ose mbyllen ose modifikohen, dhe programet e reja që janë shumë të rëndësishme për industrinë vendore dhe kanë norma të larta punësimi, vetëpunësimi janë zhvilluar me përfshirjen e industrisë. Për aftësitë teknike dhe praktike, programet e trajnimit dhe kurrikulat duhet të zhvillohen duke u bazuar në standardet e profesioneve që marrin parasysh kërkesat specifike të një nevoje të tregut të punës. Prandaj kompanitë duhet të përfshihen në mënyrë aktive si në përcaktimin e standardeve ashtu edhe në hartimin e kurrikulave.

Përgjigja dhe gjetja e zgjidhjeve më afatgjata nënkupton ndërhyrjen në programet mësimore të TIK-ut. Kriza e shkaktuar nga pandemia i ka përshpejtuar nivelet e digjitalizimit për të ndihmuar në reduktimin e ndërveprimeve fizike të cilat mund të shmangen. Kjo ka nënkuptuar gjetjen e mënyrave për të 'rishpikur' punën dhe, në disa raste, ndërprerjen e pjeshme të punës si dhe ndryshime në mënyrën se si punëtorët e kryejnë atë. Në këtë rast, vendet e punës në fushën e TIK-t janë rritur dhe kanë ofruar një shteg të qartë për të ardhmen e punës. Duke përdorur të njëjtën qasje, universiteti duhet të sigurohet që kurrikulat e tyre të vazhdojnë të mbeten në harmoni me orientimet dhe intuitën e industrisë dhe palëve përkatëse të interesit për të peshuar nevojat aktuale dhe të ardhshme për aftësi.

Më tej, politika vendore e punësimit duhet të marrë në konsideratë **metodologjitë për parashikimin e aftësive.** Metodologjia ofron informacion të plotë në lidhje me tendencat e ardhshme të tregut të punës në rajon dhe vepron si një mekanizëm paralajmërues i hershëm për të ndihmuar në zbutjen e çekuilibrave të mundshëm të tregut të punës. Praktikisht kjo përfshin informacionin në lidhje me sektorët dhe profesionet në të cilat do të rritet punësimi, kualifikimet në të cilat do të rritet ose ulet kërkesa, nevojat për zëvendësim dhe krahasimin me ofertën aktuale të punës. Megjithatë, për këtë vlerësim nevojitet përdorimi i një sistemi më të mirë për menaxhimin e informacionit të tregut të punës në nivel vendor.

6 Përfundime dhe Rekomandime

Pas vlerësimit të situatës aktuale dhe nevojave të tregut rajonal të punës dhe zhvillimit ekonomik të Elbasanit, po prezantojmë pikat kryesore. Për secilin rast janë nxjerrë përfundime dhe janë dhënë edhe disa rekomandime.

1. Rritja e Brishtë dhe Zhvillimi i Ngurtë Sektorial

Rritja e PBB-së në nivel rajonal paraqet rezultate të përziera dhe mungesën e një tendence të qartë zhvillimi, gjë që flet për një ekonomi vendore të brishtë. Për shkak të recesionit të vitit 2015 (me -4.6%) i ndjekur nga katër vjet rritje të luhatshme, me një normë mesatare vjetore prej 2.35% (deri në vitin 2019 – efekti para pandemisë COVID-19) situata është larg garantimit të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal. Pjesa më e madhe e PBB-së në Elbasan vjen nga bujqësia (40.2% në vitin 2020) dhe ekonomia dominohet kryesisht nga ndërmarrjet e vogla bujqësore, shumica e të cilave janë biznese familjare. Gjatë viteve të shkuara, kjo strukturë nuk ka parë ndonjë ndryshim të rëndësishëm, gjë që demonstroi ngurtësinë dhe mungesën e inovacionit. I vetmi ndryshim i dukshëm është rritja e vogël e sektorit të industrisë nga 12.5% në 15.0% të PBB-së vendore.

Rezultatet e konsultimeve me Bashkinë e Elbasanit (si aktori kryesor i zhvillimit rajonal) dëshmojnë se, megjithë hapat e vegjël të përparimit, ekzistojnë të gjitha mundësitë si dhe forcat shtytëse për të ndikuar në rritjen e konsiderueshme të rajonit. “Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Elbasan 2016”, e fokusuar tek objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit, ka shërbyer si dokumenti kryesor dhe orientues për politikën ekonomike rajonale. Ndërsa strategjia është gjithëpërfshirëse, objektivi i parë ofron narrativën e zhvillimit dhe natyrën ndërsektoriale të saj, ndërsa objektivi i katërt e njeh bujqësinë si sektorin kryesor që nxit rritjen ekonomike. Më tej, programet e identifikuar ofrojnë një kuadër të shëndoshë ndërhyrës.

Konsultimet me Bashkinë e Elbasanit treguan se ky kuadër është mjaft thelbësor për punën e bashkive, por në fakt asnjëri projekt nuk shoqërohet me një plan të detajuar zbatimi. Në lidhje me projektet e sektorit industrial ka pasur progres, veçanërisht për shkak të interesit në rritje nga kompanitë e mëdha për të vendosur biznesin e tyre në zonën metalurgjike si dhe në zonën ekonomike të Elbasanit. Nga ana tjetër, megjithë iniciativat e vogla, programet bujqësore nuk kanë qenë aq shumë të suksesshme sa për të ofruar një transformim thelbësor në sektorin e bujqësisë. Sipas bashkisë, bujqësia është ende në gjendjen e saj parësore: kryesisht prodhim dhe përpunim i rastit.

Ndërhyrjet e rekomanduara në këtë rast i përkasin pushtetit vendor dhe qendror dhe duhet të udhëhiqen nga teoria e ndryshimeve strukturore. Teoria përshkruan mekanizmin me anë të të cilit ekonomitë e pazhvilluara i transformojnë strukturat e tyre ekonomike të brendshme duke e zhvendosur theksin nga bujqësia tradicionale si mjet jetese tek ekonomia e prodhimit dhe shërbimeve më moderne, më të urbanizuara dhe më të larmishme në aspektin industrial. Rekomandimi përfshin krijimin e programeve specifike në nivel rajonal ose bashkiak për zhvillimin strukturor dhe planin e detajuar të zbatimit.

Duke marrë parasysh rolin aktual të bujqësisë dhe potencialin e saj, zhvendosja fillimisht duhet të marrë në konsideratë tre fazat e bujqësisë: prodhimi, magazinimi dhe përpunimi. Për të rritur vlerën e shtuar nga bujqësia dhe për të siguruar bazat për ndryshimin strukturor, synimi specifik duhet të jetë zhvendosja e aktivitetit bujqësor nga pothuajse tërësisht prodhim në përpunim. Hapi fillestar i këtij procesi është identifikimi i fushave bujqësore të përpunueshme dhe vlerësimi i

përfitimit. Hapi i radhës, në bashkëpunim me AZHBR-në duhet të jetë sigurimi i financimit për këto lloj aktivitete. Duke qenë se aktualisht ekzistojnë ferma të vogla të përpunimit bujqësor (sipas Bashkisë së Elbasanit), strategjia ka të ngjarë të tërheqë vëmendjen e prodhuesve bujqësorë. Megjithëse logjika e ndërhyrjes duket e qetë, faktori kryesor për garantimin e suksesit është tërheqja e fondeve, pasi prodhuesit vendas bujqësorë kanë burime të kufizuara, ashtu si edhe vetë bashkitë. Prandaj, synimi i bashkive është të ofrojnë njohuritë dhe aftësitë praktike dhe të negociojnë në lidhje me mundësitë e financimit nga agjencitë qendrore.

Më tej, në përputhje me “Strategjinë për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Elbasan” për vitin 2016, është e nevojshme që të rritet ekspozimi i zonës metalurgjike si zonë industriale. Projekti i hekurudhës së re të Elbasanit dhe projekti pasues për portin e Durrësit, në një periudhë afatmesme do ta vënë zonën në qendër të vëmendjes për industri të ndryshme, si për investitorët vendas ashtu edhe për investitorët e huaj. Duke qenë se aktualisht ka ndërmarrje të interesuara për këtë zonë, strategjia afatshkurtër duhet të synojë *unifikimin dhe promovimin e ofertës*. Konkretisht, nevoja për të arritur këtë duhet të reflektohet në një dokument gjithëpërfshirës ku përshkruhen llojet e ambienteve të ofruara, llojet e shërbimeve në dispozicion dhe mbështetja nga bashkia ose agjencitë e tjera lokale (përfshirë ofertën e fuqisë punëtore nga AKPA), së bashku me avantazhet aktuale dhe të ardhshme të vendndodhjes së kësaj zone. Ky lloj dokumenti duhet të konsiderohet edhe si dokument pilot, që më pas të shtrihet në programe apo shërbime të tjera.

2. Migrimi i Fuqisë Punëtore të Kualifikuar

Treguesit e nivelit makro të tregut të punës në Elbasan paraqesin një perspektivë të përzier të pjesëmarrjes dhe papunësisë në rajon. Megjithëse gjatë 5 viteve të fundit është vënë re një rënie të lehtë (-3,9 pp), shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2020 ishte 71% dhe rreth 9,4 pp mbi mesataren kombëtare prej 60,6%. Krahasuar me rënien e shkallës së pjesëmarrjes, norma e papunësisë pësoi një rënie shumë më të lartë duke shkuar nga 13.9% në vitin 2016 në 7.1% në vitin 2020. Megjithatë, popullsia gjatë viteve 2016-2020 ra me një normë mahnitëse prej rreth 6%, ose saktësisht 17,532 banorë (të dhënat e INSTAT, referojuni Figurës 6).

Pra, siç paraqitet nga të dhënat e mësipërme, në radhë të parë, zhvillimi i tregut të punës në qarkun e Elbasanit po përballet me një problem thelbësor në nivel makro. Përveç trendeve natyrore demografike, migrimi i fuqisë punëtore aktive është identifikuar si një problem i madh dhe i qartë, gjë e cila krijon probleme të shumta për çdo politikë të tregut të punës. Në thelb, duke qenë se rënia e popullsisë është e vazhdueshme, kjo nënkupton edhe një ulje të vazhdueshme të ofertës së punës. Tendencat e mëtejshme të migrimit (të brendshme ose të jashtme) dominohen kryesisht nga grupmoshat më të reja dhe fuqia punëtore e kualifikuar,¹³ duke sugjeruar një efekt shumë më të fortë në reduktimin e ofertës së fuqisë punëtore të kualifikuar dhe në moshë më të re.

Dallimet midis mundësive të punësimit në Tiranë dhe Elbasan të shkaktuara nga prirja e përqendrimit, veçanërisht kryeqytet-qytet, dhe strategjive të zhvillimit duhet të reduktohen. Për shkak se migrantët supozohet se reagojnë ndaj diferencave në të ardhurat e pritshme, është me rëndësi jetike që të minimizohet çekuilibri ndërmjet mundësive ekonomike midis rajoneve dhe Tiranës. Kur normat e pagave në Tiranë rriten më shpejt se të ardhurat mesatare në Elbasan, ato stimulojnë migrimin e mëtejshëm. Ky fluks i madh i fuqisë punëtore në Tiranë krijon jo vetëm probleme që lidhen me mungesën e fuqisë punëtore, por edhe me mungesën e sipërmarrjes. Përveç kësaj, hapja e vendeve të punës në Tiranë është një zgjidhje e pamjaftueshme për problemin

¹³ Russell King & Ilir Gëdeshi (2020) *New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed?, Migration and Development*, (Tendencat e reja në migrimin e mundshëm nga Shqipëria: është shtyrë tranzicioni i migracionit?, Migrimi dhe zhvillimi), 9:2, 131-151.

e papunësisë në nivel vendor. Koncepti thelbësor këtu lidhet me mungesën e ekuilibrit të mundësive për fitimin e të ardhurave të pritshme. Për shkak se normat e migracionit supozohet se i përgjigjen pozitivisht pagave më të larta dhe mundësive më të larta të punësimit në Tiranë, diferencat e larta pozitive të pagave midis Tiranës dhe Elbasanit do të zgjerojnë hendekun e pritshëm dhe do të gjenerojnë një rezultat shumë më negativ për qarkun e Elbasanit.

Migrimi i fuqisë punëtore të kualifikuar është konfirmuar edhe nga Bashkia Elbasan dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit dhe Formimit Profesional, të cilët pretendojnë se arsyeja kryesore për këtë është ndryshimi i nivelit të pagave. Një shembull tipik është migrimi i punëtorëve teknikë në Gjermani, të cilët përmes trajnimeve të ndryshme fitojnë aftësi të certifikuara dhe migrojnë për të punuar në Gjermani. Tipologjia e punëtorëve që migrojnë në Tiranë (sipas këtyre palëve të interesuara) përfshin kryesisht punëtorët shumë të specializuar duke përfshirë TIK-un, shërbimet financiare, inxhinierinë etj. Ata janë të gatshëm të punojnë në Tiranë dhe për diferencat të vogla në paga për shkak të perspektivës më të mirë profesionale.

Politika publike në pothuajse 30 vite ka dështuar në përpjekjet e saj për trajtimin e duhur të problemit të migracionit për shkak të kompleksitetit të tij të jashtëzakonshëm. Megjithatë, ky fenomen mund të frenohet nëpërmjet disa hapave në rritje. **Ndërhyrja e rekomanduar është që zyra rajonale e punësimit të promovojë vendet e lira të punës për të cilat kërkohen kualifikime të larta dhe të garantojë plotësimin e tyre përmes sensibilizimit dhe komunikimit më të mirë.** Me përjashtim të bujqësisë, rreth 43% e sipërmarrjeve aktive janë të regjistruara në zyrën vendore të punësimit në Elbasan, që përfaqëson një rreze mjaft të kufizuar për vende të mundshme pune. Fushata për sensibilizimin e biznesit duhet të përfshijë një sërë kanalesh komunikimi dhe pikash kontakti për të ofruar mënyra të shumta për punëdhënësit që të njohin dhe të shfrytëzojnë shërbimet e zyrës së punësimit. Të gjitha aktivitetet sensibilizuese duhet t'i kanalizojnë punëdhënësit në një bazë qendrore të dhënash dhe kjo duhet të shoqërohet me ndjekjen e mëtejshme e të koordinuar për të përmbushur nevojat e punëdhënësve, për të dokumentuar aktivitetet e stafit dhe për të monitoruar progresin dhe suksesin.

Nga ana e ofertës, zyra rajonale e punësimit duhet të fokusohet edhe tek **mjetet e menaxhimit të karrierës për integrim të qëndrueshëm në tregun e punës.** Shërbimet e orientimit për karrierën mund të ofrohen në rastet kur punonjësit përballen me largimin nga puna ose me shkurtimin e vendit të punës, kur vendosin të ndryshojnë vendin e punës, të migrojnë brenda ose jashtë ose kur duan të kombinojnë punën me të nxënien. Shërbimet e orientimit për karrierën duhet t'i ndihmojnë punëkërkuarët për kalimin e qëndrueshëm drejt punësimit ose nga njëri vend pune në tjetrin. Në këtë kontekst, këto mjete menaxhimi duhet të fokusohen kryesisht në ruajtjen e fuqisë punëtore të kualifikuar brenda rajonit, duke ofruar alternativat më të mira të mundshme dhe duke lehtësuar tranzicionin.

3. Sistemi i Informacionit për Tregun Rajonal të Punës

Ky raport do të shërbejë si bazë për analizën rajonale të tregut të punës. Megjithatë, për disa nga çështjet e identifikuar do të nevojitej një qasje më dinamike. Institucionet kryesore të lidhura me tregun e punës duhet të kenë një bashkëpunim më të prekshëm. Aktualisht AKPA dhe Bashkia e Elbasanit kanë hedhur bazat për të bashkëpunuar në këtë kuadër, por nuk kanë përgatitur ende një strategji të përbashkët në lidhje me mënyrën konkrete të bashkëpunimit.

Ndërhyrja e rekomanduar është krijimi i Sistemit të Informacionit për Tregun e Punës (SITP). I gjithë informacioni për tregun e punës, i cili përfshin strukturën, karakteristikat dhe dinamikën e ofertës së punës (p.sh., përbërjen, aftësitë ose kualifikimet e saj) dhe kërkesën për punë

(vendndodhja e punëdhënësve, industria, sektorët, nevojat për aftësi, llojet e vendeve të punës që ofrohen, praktikat e punësimit, etj.), njihet si informacioni për tregun e punës. SITP do të shërbejë si një mjet për të lehtësuar analizën e tregut të punës dhe si një mekanizëm për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e punës ndërmjet Zyrës Vendore të Punësimit, Bashkive dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit dhe Formimit Profesional që do të prodhojë dhe shfrytëzojë informacionin dhe analizën e tregut të punës.

Portali i ri i punës në internet (*puna.gov.al*) dhe baza e të dhënave përkatëse është një fillim i mbarë për këtë sistem. SITP përbëhet nga katër komponentë:

- mbledhja dhe përpilimi i të dhënave dhe informacionit;
- ruajtja e informacionit;
- kapaciteti dhe mjetet analitike; dhe
- modalitetet dhe rrjetet institucionale.

Aktualisht janë krijuar dy komponentët e parë. Ky raport ofron bazën për komponentin e tretë, ndërkohë që duhet të përgatiten modalitetet dhe rrjetet institucionale. Institucionet e përmendura duhet të përcaktojnë rolin e tyre për menaxhimin e SITP-së. Zyra e Punësimit ka një rol qendror dhe udhëheqës, ndërsa bashkitë duhet ta përdorin sistemin për të promovuar pjesëmarrjen aktive të ndërmarrjeve private dhe për të zhvilluar strategjitë e tyre. Ndërsa Drejtoria Rajonale për Arsimin dhe Formimin Profesional mund të ofrojë informacion për ofertën e fuqisë punëtore, ndërkohë që kryen analizën për parashikimin e aftësive, e cila do të përdoret për përshtatjen e kuotave dhe të kurrikulës së AFP-së.

4. Përputhja e ofertës dhe kërkesës për aftësi

Krahasimi i vendeve të lira të punës dhe i numrit të papunëve të regjistruar sipas profesionit, paraqet një tablo të mirë të mospërputhjeve të mundshme të aftësive në tregun e punës. Rezultatet tregojnë se për vitin 2020, çdo vend i lirë pune i kategorizuar sipas profesionit përputhet dhe tejkalohet nga të papunët e regjistruar në të njëjtën kategori dhe për secilën prej kategorive. Megjithatë, gjatë eksplorimit të mëtejshëm të nënkategorive, na shfaqet vetëm një nënkategori ku numri i vendeve të lira të punës është më i lartë sesa numri i të papunëve të regjistruar: konkretisht këtu bëhet fjalë për zejtarët që përpunojnë ushqime, dru, tekstile, etj., brenda kategorisë "zejtarët dhe profesionet e ngjashme". Pra, mund të arrijmë në konkluzionin që mospërputhja e aftësive nuk është problematikë e përhapur në tregun e punës.

Megjithatë, kalimi nga kategoritë e gjera në ato më specifike mund të çojë në gabim përlllogaritjeje, pasi mund të na bëjë të mendojmë se rezultati që është i vërtetë për grupin duhet të jetë i tillë edhe për nëngrupin: sa më të agreguara të jenë të dhënat, aq më çorientuese janë ato. Konsultimet me aktorët vendorë nxorren si përfundim ekzistencën e mospërputhjes midis ofertës dhe kërkesës për punë në rajon, ndërkohë që bizneset luftojnë për të marrë punonjësit me tërësinë e duhur të aftësive, dhe kryesisht kur merret parasysh niveli i aftësive.

Ndërhyrja e rekomanduar është përmirësimi i kategorive të ofertës dhe kërkesës të regjistruara në zyrën e punës, duke pasuruar sasinë e informacionit si dhe përmbajtjen e tij. Megjithatë, identifikimi efektiv i aftësive jo vetëm që kërkon zhvillimin e informacionit cilësor në lidhje me tregun e punës, por edhe kërkon qasjen tek të dhënat përkatëse nga palët e interesuara jashtë shërbimeve publike të punësimit, si dhe kapacitetin për të analizuar këto të dhëna. Identifikimi sa më efektiv i aftësive thelbësore për punëtorët kërkon ekzistencën e mjeteve matëse dhe të kapaciteteve për të analizuar informacionin dhe lidhjet ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë dhe aftësi (mundësisht përmes Sistemit të Informacionit për Tregun e Punës). Për ta arritur këtë,

zyrat e punësimit duhet të përdorin gjithnjë e më shumë një qasje më holistike që largohet nga mbledhja e thjeshtë e informacionit në lidhje me të dhënat e punësimit, përvojën e punës dhe kualifikimet formale të një punëkërkuesi individual dhe të lëvizë drejt njohjes dhe përshkrimit të aftësive gjenerike dhe ndërpersonale të punëkërkuetit, si dhe të aftësive të zhvilluara përmes të nxënimit informal.

5. Fuqia punëtore me kualifikim të ulët, të moshuar dhe të papunë afatgjatë

Sipas rezultateve të dala nga vlerësimi, fuqia punëtore aktuale e papunë është fuqi punëtore me aftësi dhe kualifikim të ulët. Ndërkohë që përvijojmë më tej zhvillimin afatgjatë të kapitalit njerëzor dhe parashikimin e aftësive, së pari ekziston nevoja për t'iu qasur pikërisht kësaj fuqie punëtore aktuale me këtë nivel aftësish. Por ajo që e përkeqëson këtë situatë është edhe fakti që kjo fuqi punëtore karakterizohet edhe nga moshja më e madhe dhe papunësia afatgjatë. Periudha e papunësisë për individët e ndryshëm shoqërohet edhe me venitjen e aftësive të tyre, gjë që çon gradualisht dhe me kalimin e kohës në zhvlerësimin e kapitalit njerëzor. Kjo nënkupton që shanset që individët të gjejnë një punë të re ulen ndjeshëm, sa më gjatë që të qëndrojnë pa punë. Për më tepër, punëtorëve të moshuar iu ka mbetur vetëm një periudhë e shkurtër punësimi potencial dhe punëdhënësit mund t'i konsiderojnë ata si më pak fleksibël dhe për këtë arsye më pak tërheqës sesa fuqia punëtore më e re. Midis këtyre grupeve mund të ketë mungesë të aftësive teknike, ose vjetrim të këtyre aftësive dhe njohurive nëse ato nuk përditësohen rregullisht krahas me zhvillimin e sektorit përkatës. Ndoshta kjo ka ardhur si rezultat i faktit që shumë prej punëtorëve të moshuar kanë hyrë në tregun e punës me kapital të ulët njerëzor dhe janë përpjekur shumë pak për të lehtësuar situatën e tyre.

Ndërhyrja e rekomanduar është përfshirja e trajnimeve në vendin e punës të bashkë-projektuar dhe financuara nëpërmjet koordinimit institucional (AKPA dhe bashkitë) në bashkëpunim me bizneset. Vendet e lira të punës përfshijnë ato vende që kërkojnë aftësi teknike, por nuk kërkojnë nivel të lartë të kapitalit njerëzor. Këto aftësi teknike (si zejtaria) janë të arritshme edhe në rastin e fuqisë punëtore me kualifikim të ulët, afatgjatë dhe të moshuar. Megjithatë, këtu është e rëndësishme të merret në konsideratë teoria e kapitalit njerëzor dhe mënyra se si individët vendosin të investojnë për zhvillimin e aftësive të tyre – duke u përballur edhe me kostot por edhe me kthimin e investimit. Kthimet dhe kostot përfshijnë komponentë monetarë dhe jomonetarë, ndërsa teoria parashikon që një individ do të marrë pjesë në trajnim kur kthimet në trajnim janë më të mëdha se kostot. Argumente të ngjashme vlejnë për firmat, të cilat do të investojnë në trajnime nëse kthimet janë më të mëdha se kostot. Prandaj, për të rritur me sukses aftësitë e kësaj kategorie të fuqisë punëtore, politika e punësimit duhet të mbështesë kostot - kostot e trajnimit dhe kostot stimuluese për fuqinë punëtore, si dhe koston e punësimit nëse zgjidhet një trajnim më efektiv në vendin e punës.

6. Papunësia afatgjatë dhe puna informale

Rezultatet tregojnë se numri i të papunëve të regjistruar në zyrat vendore të punësimit është më i lartë sesa shkalla e vlerësuar e papunësisë në rajon. Zakonisht kjo vë në dukje informalitetin në tregun e punës, veçanërisht në punën e rastësishme ku kërkohen aftësi të ulëta. Kjo u konfirmua edhe gjatë konsultimeve me Bashkinë e Elbasanit. Sipas tyre, një pjesë e konsiderueshme e të papunëve të regjistruar (që marrin pagesë papunësie) zakonisht i refuzojnë ofertat e punës nga zyrat rajonale të punës, për shkak të aktivitetit të tyre në ekonominë informale. Fenomeni është zakonisht i pranishëm në zonat rurale dhe të largëta, dhe duke qenë se Inspektorati Shtetëror i Punës ndodhet në qytetin e Elbasanit, shtrirja e tij në aspektin e inspektimit është e kufizuar. Papunësia afatgjatë rrit koston e shërbimeve sociale dhe sjell financa publike të paqëndrueshme,

ndërkohë që shtrembëron edhe dinamikën e tregut. Të gjitha këto pasoja negative mund të justifikojnë arsyen për vënien e theksit të fortë mbi punën dhe punëkërkimin në strukturën e politikës social-profesionale.

Ndërhyrja e rekomanduar është përditësimi i rrjetit të sigurimit kundër papunësisë, me një zhvendosje nga pagesat e papunësisë tek politikat më aktive, veçanërisht pagesat shtesë për ripunësimin dhe programet për sigurimin e pagave. Këto të dyja mund të shërbejnë si stimuj për të papunët rishtarë për të gjetur punë më shpejt dhe për të mos rrezikuar papunësinë afatgjatë. Pagesa shtesë për ripunësimin është një pagesë e njëhershme për punëtorët e papunë që gjejnë një punë të re brenda një kohe të caktuar. Programet për sigurimin e pagave përbëjnë një pjesë të diferencës midis normës së re të pagës së një punonjësi dhe normës së pagës në punën e tij të mëparshme (ose në punën aktuale informale) për një kohë të caktuar, e cila mund të kombinohet edhe me programet e trajnimit në vendin e punës. Ideja prapa të dyja qasjeve në fjalë është se në treg ekzistojnë vende pune për të papunët rishtarë, por shpërblimi i pamjaftueshëm i bën ato të padëshirueshme për individët e papunë.